



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: Shkenca Politike me profile: “Administratë Publike”, “Gazetari”, “Studime Europiane”**

**Universiteti European i Tiranës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Dr.Elda ZOTAJ**

**Dr.Ejona ISUFAJ**

**Dhjetor / 2022**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Bachelor në Shkenca Politike me profile: “Administratë Publike”, “Gazetari”, “  
Studime Europiane”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Shkenca Politike me profile: a. Administratë Publike; b. Partitë Politike; c. Sociologji Politike; d. Gazetari; e. Studime Europiane; *
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 636, datë 20.09.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati me Nr. 07 Prot, datë 14.06.2018 Miratuar nga MASR me shkresën Nr. 8244/1 Prot, datë 04.09.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 161 datë 07.04.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 Vite/ 6 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	32 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	- 2019 -2020; 22 studentë; - 2020-2021; 9 studentë; - 2021-2022 11 studentë;
19	Komente / të tjera:	Procesi i vlerësimit të jashtëm vlen vetëm për 3 (tre) profile

\* Emërtimi i programit të studimit është me 5 (pesë) profile, por UET nëpërmjet shkresës me Nr.163/3 Prot, datë 26.11.2021, kërkon akreditim vetëm për 3 (tre) profilet që janë aktive, profilet “Partitë Politike”, dhe “Sociologji Politike”, nuk janë pjesë e këtij vlerësimi

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor 'Shkenca Politike' me profile "Administratë Publike", "Gazetari", "Studime Europiane" ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhëniesve Ndërkombëtare të Universitetit Europian i Tiranës. Ky program studimi licensuar me VKM Nr. 636, date 20.09.2006, si Bsc në "Shkenca Politike", është riorganizuar në Bsc Shkenca Politike me profile: a. Administratë Publike, b. Partitë Politike, c. Sociologji Politike, d. Gazetari, e. Studime Europiane, me Vendim Senati, nr 7 prot, datë 14.06.2018, dhe miratuar nga MASR me shkresën Nr. 8244/1 Prot, datë 04.09.2018, ndryshimet në masën 20%.

Programi i studimit realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademik (6 semestra/ 180 kredite), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Bachelor "Shkenca Politike", me profile: "Administratë Publike", "Gazetari", "Studime Europiane".

Ky program studimi synon të ofrojë tek studentët njohuri të thelluara në lëmin e Shkencave Politike duke i mundësuar dhe një orientim në profilet që karakterizojnë këtë kurrikul në vitin e tretë në "Administratë Publike", "Gazetari" apo "Studime Europiane". Ky program studimi synon të pajisë studentin me dije dhe njohuri formuese gjithashtu ti krijojë mundësinë e zgjedhjes për një profil paraprak orientues. Programi mbështetet nga një staf pedagogjik i specializuar në këtë fushë dhe me eksperiencë në fushën e mësimdhënies.

*UET sipas shkresës me Nr.163/3 Prot, datë 26.11.2021, kërkon akreditim vetëm për 3 (tre) profilet që janë aktive, profilet "Partitë Politike", dhe "Sociologji Politike", nuk janë pjesë e këtij vlerësimi.*

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Raporti është përgatitur nga një grup ekspertësh të vlerësimit, njohur si Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), ngritur nga ASCAL me Urdhër Nr.58, datë 15.03.2022, në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë caktoi: Dr Elda Zotaj si dhe Dr Ejona Isufaj, si ekspertë të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion dhe procedurës lidhur me vlerësimin e jashtëm, ekspertët e jashtëm u asistuan nga përfaqëuesja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli.

Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Grupi, në vlerësimin e tij është bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dorëzuar nga UET, dokumentacioni shoqërues i raportit dhe mbi vizitën organizuar pranë këtij institucioni më 9-10 Qershor 2022. Po ashtu, Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet ligjore e nënligjore përkatëse, dhe udhëzimet e ASCAL-it. Gjatë vizitës në UET, GVJ ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e UET të përfshirë në këtë proces, nga strukturat drejtuese të fakultetit, anëtarët e departamenti deri tek zyrtarë menaxheriale dhe horizontale siç janë burimet njerëzore, sekretaria e mësimore, si dhe takime me studentët e programit.

## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike, është akredituar me Urdhër të MASR Nr. 161, datë 07.04.2016, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 129, datë 18.02.2016. Referuar këtij Vendimi Këshilli i Akreditimit **nuk ka lënë rekomandime** për këtë program studimi.



Universiteti Europian i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 24.10.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 87/121 Prot, datë 24.10.2022. Universiteti Europian i Tiranës përcjell në ASCAL më datë 26.10.2022, me anë të shkresës me Nr. 78/128 Prot, datë 25.10.2022, “Kthim Përgjijge mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

### Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Shkenca Politike, me profile: a. Administratë Publike, b. Gazetari, c. Studime Europiane”.

#### I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administratë Publike”, “Gazetari”, “Studime Europiane”, ofrohet në shërbim të interesave kombëtare. Në Statutin e UET ( <i>neni 6</i> ) është dhënë vizioni i tij si institucion që kontribuon “për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qëndër ekselence në formimin akademik të studentëve...” si dhe misioni i tij për “t’i shërbyer dijes së shoqërisë shqiptare” nëpërmjet realizimit të një “procesi cilësor edukimi”. Në dokumentin e titulluar “Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të studimit BA_SHP” thuhet se: “Programi ka si synim përgatitjen e specialistëve në fushën e Shkencave Politike të aftë për tu integruar në tregun e punës me kompetencat përkatëse”. Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore të vendit.

	<i>(Evidencë: nr.2. Statuti i UET; nr.4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit BA_SHP)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor “Shkenca Politike” me profile “Administratë Publike”, “Gazetari”, “Studime Europiane” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Në dokumentin e titulluar Plani Strategjik UET 2021-2025 (fq.2), theksohet se “<i>UET të punoj për thellimin e traditave më të mira universitare shqiptare, si dhe të kontribuoj në thellimin e lirisë akademike, dëshirës për ndjekjen e studimeve universitare, krijimin e disiplinës akademike e intelektuale në emër të karrierave sa më të qëndrueshme e cilësore...etj</i>”. Programi i studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile, zbatohet në rrethanat kur kërkohet të thellohen e konsolidohen më tej vlerat demokratike dhe forcimi i demokracisë dhe institucioneve të vendit. Përmes shërbimit të procesit mësimor, programi i studimit ndihmon në forcimin e vlerave akademike e atyre kulturore kombëtare.</p> <p><i>(Evidencë: nr.3.3.Plani Strategjik UET 2021-2025; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Ka një përputhje të kënaqshme të programit të studimit me misionin dhe qëllimin e institucionit duke marrë parasysh që ky është ndër programet e para që ka hapur ky institucion. Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet bazuar në dokumentet themelore të institucionit si në Statut, Rregullore apo në Strategjinë e Kërkimit 2021-2025. Ky program është në përputhje me misionin e fushën e veprimtarisë së UET për të qënë “qendër ekselence në formimin akademik të studentëve..., qendër ekspertize e specializuar në fushën e studimeve shoqërore-politike..., qendër ekselence për kërkimin shkencor”.</p> <p><i>(Evidencë: nr.2. Statuti i UET; nr.3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p>Programi i studimit është hartuar duke synuar të mbështesë e të nxisë nevojat e zhvillimit ekonomik në nivel lokal e qendror. Ky program studimi i shërben formimit të specialistëve në shkencat politike, në sektorin e shoqërisë civile, media, organizma politike, administratën publike që do të kontribuojnë në sektorin publik dhe jo vetëm përmes diplomës Bachelor “Shkenca Politike” me profile “Administratë Publike”, “Gazetari”, “Studime Europiane”. Ky format diplome bachelor me profile nuk haset në institucione të tjera gjë që mund të përbëjë një risi për tregun</p>

	<p>e punës. Në dokumentin “Mendimi i Dekanit per programin SHP” thuhet se “Ky program ka për qëllim të ofrojë një kurrikul konkurruese në tregun e punës për formimin e specialistëve në fushën e shkencave politike, në përputhje me zhvillimin politik dhe shoqëror të vendit. Në fokus të këtij programi është mënyra e organizimit dhe e funksionimit të institucioneve në një shoqëri në zhvillim, në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian”. Programi synon të furnizojë tregun me specialist njohës të politikës dhe administrimit duke i shërbyer rritjes së performancës së institucioneve publike dhe zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.</p> <p><i>(Evidencë: nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike; nr.1. Mendimi i Dekanit per programin SHP)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Në dokumente të tilla si: Plani Strategjik 2015-2020 dhe 2021-2025, Rregullorja e UET, Statuti i UET, Rregullorja e Programit të Studimit konfirmohet dhe vlerësohet qasja e rëndësishme për zhvillimin e programit të studimit në harmoni me politikën zhvillimore të institucionit. Gjithashtu nga shqyrtimi i syllabuseve dhe strategjisë së përgjithshme të programit, nga biseda me Përgjegjësin e Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara, nga ofrohet ky program si edhe stafin përkatës të programit, rezulton se ai është hartuar në përputhje me misionin e strategjinë e përgjithshme të UET, por edhe me standardet ndërkombëtare. Programi është konceptuar, bazuar në strategjinë e institucionit, për të përgatitur formimin e specialistëve në fushën e shkencave politike.</p> <p><i>(Evidencë: nr.3. Plani Strategjik 2015 – 2020; nr.3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025; nr.5. Rregullore e UET; nr.4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit BA_SHP)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet	Nga shqyrtimi i Statutit, Rregullores, Planit strategjik të UET 2021-2025, dhe gjithë dokumentacionit të Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara në lidhje me kriteret e

<p>prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>organizimit e funksionimit të programit të studimit Bachelor “Shkenca Politike” me profile “Administratë Publike”, “Gazetari”, “Studime Europiane”, rezulton se programi aplikohet në përputhje të plotë me to. Sikundër citohet në dokumentin Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit BA_SHP: “Ky program mbështetet në strategjinë institucionale të UET, të zbatuar konkretisht për studimet në fushën e Shkencave Politike, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale dhe ato të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, dhe atyre të vetë Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara” (Evidencë: nr.4. fq.1 ). Ky program synon gjithashtu si pjese e planit strategjik të institucionit “diversifikimit të ofertës së tij akademike e shkencore dhe në drejtime të tjera që vlerësohen se kërkohen nga tregu i punës” (Evidencë: Plani Strategjik 2015-2020, fq.8). Programi i ofruar me profile, është një përpjekje për të zgjeruar profilin e institucionit me fusha studimi që u përgjigjen nevojave të zhvillimeve dinamike sociale, politike dhe kulturore në vend. (Evidencë: nr.2. Statuti i UET; nr.3 Plani Strategjik 2015-2020; nr.5. Rregullore e UET; nr.4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit BA_SHP)</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Programi, i konceptuar si në emërtim, ashtu edhe në strukturë e organizim është brenda një prej fushave e drejtimeve akademike të institucionit, (Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare), përbën një përpjekje edukative që synon t’u japë studentëve akses në njohuritë e shkencave politike dhe thellim të tyre në një nga tre drejtimet e përzgjedhura. (Evidencë: nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi I.3</b> <b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administratë Publike”, “Gazetari”, “Studime Europiane”, ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve. Në dokumentin <i>Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit BA_SHP</i> thuhet se: “Ky program</p>

<p>dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p><i>synon të pajisë studentin me formim akademik, shkencor dhe bashkëkohor, mbështetur në prioritetet strategjike përkatëse, që lidhen me rritjen e vazhdueshme të cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies, lidhur me lëndët specifike të fushës së Shkencave Politike, duke realizuar formimin e një studenti cilësor dhe të pregatitur në fushën e shkencave politike, studimeve europiane, administratës publike, medias dhe oraganizatave kombetare dhe ndërkombëtare (në përputhje me profilet që ofron ky program studimi).”</i></p> <p>Gjithashtu në dokumentin Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike (fq.2-3) janë të specifikuar objektivat:</p> <p><i>Programi i studimit Bachelor, synon ta pajisë studentin me:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><i>a. Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit;</i></li> <li><i>b. Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale;</i></li> <li><i>c. Formim qytetar të përgjithshëm;</i></li> <li><i>d. Aftësi bazë për punë kërkimore;</i></li> <li><i>e. Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; 8</i></li> <li><i>f. Aftësim për promovim personal;</i></li> <li><i>g. Diplomë pa origjinalite</i></li> </ul> <p>Në rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar qartë edhe mundësitë e punësimit/profesionet përkatëse për të diplomuarit.</p> <p><b><i>(Evidencë: nr.4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit BA_SHP; nr. 7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike)</i></b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe</p>	<p>Mbështetur në takimet e GVJ në institucion si dhe në dokumentacionin përkatës, rezulton se UET ka një përvojë të konsoliduar në marrëdhëniet e komunikimin zyrtar me punëdhënësit e përfaqësues të tregut të punës (në varësi të profileve e fushave akademike që institucioni ofron. Në evidencën <b>12.1. Bordi i Tregut të Punës</b>, dokumenti ka antarët e këtij bordi për Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara). Kjo strukturë Bordi i Tregut të Punës (BTP) kontribuon në njohjen e kërkesave dhe nevojave të institucionit lidhur me mundësitë e punësimit të studentëve. Drejtuesi i Departamentit është përgjegjës për mbajtjen e marrëdhënieve me këtë strukturë. Strukturat brenda institucionit kryejnë studime mbi tregun lokal e</p>



zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	<p>ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron. Gjithashtu, departamenti kryen studime periodike të tregut të punës dhe analizon përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. <i>(Evidencë nr.35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit). Në dokumentin Studimi për tregun e punës - Departamenti SSHA (Evidencë nr.17)</i></p> <p>Eshtë realizuar një analizë mbi gjendjen aktuale të vendit lidhur me zhvillimin social dhe ekonomik. Institucioni disponon të dhëna për punësimin real të studentëve të diplomuar <i>(Evidencë nr.17 “Tabela nr. 1: Shkalla e punësimit ndër vite për studentët e diplomuar në programin BA” dhe nr.29. Të dhëna për punësimin e studentëve Tab 23 - BA SHP)</i> ku për vitin akademik 2019-2020 rezultojnë të punësuar 9% e të diplomuarve. Gjithashtu, vlen të përmendet se programi është riorganizuar duke marrë parasysh si kërkesat e tregut të punës, ashtu dhe interesat e vetë studentëve. <i>(Evidencë RVB - BA_Shkenca Politike)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga biseda që GVJ zhvilloi me stafin mësimor të programit, studentët dhe njohja e dokumentacionit, rezulton se me objektivat formues, strukturën dhe përmbajtjen e programit është synuar në arritjen e dijeve, aftësive dhe kompetencave që i përgatisin studentët për tregun e punës. Kjo reflektohet në analizat vjetore dhe periodike të departamentit <i>(Evidencë nr. 38. Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP)</i>, në vlerësimin dhe mendimin e Dekanit të fakultetit <i>(Evidencë nr.1. Mendimi i Dekanit per programin SHP)</i>, në rregulloren e programit të studimit apo në dokumenta të tjera. Studentët treguan për përvojën përgjithësisht pozitive të përfutur gjatë zhvillimit të këtij programi duke argumentuar rëndësinë e përmbajtjes së tij për t’iu përgjigjur problematikave që dalin nga aktualiteti. <i>(Evidencë: Shenime UET)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi I.4</b></p> <p><b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën,</p>	<p>Universiteti European i Tiranës përbën një institucion të arsimit të lartë të mireorganizuar dhe me eksperiencë të</p>

<p>kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>konsiderueshme në Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ku përfshihet dhe ky program studimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet e realizuara në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka angazhuar në mësimdhënie, në këtë cikël studimi, personel të kualifikuar mësimdhënës, me titujt dhe grada shkencore (<i>Evidencë nr. 38. Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP, fq.10-15</i>). Në Planin Strategjik për zhvillimin e këtij programi, theksohet synimi për të ofruar “mësimdhënie me pedagogët më të mirë shqiptarë, në bashkëpunim me profesorë të ftuar nga disa prej universiteteve më të mira të Europës, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit; Pedagogët që japin mësim në degën e Shkencave Politike janë nga pedagogët më të shquar të fushës me një përvojë të gjatë dhe botime shkencore të rëndësishme”.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej <b>31 pedagogë</b>, nga të cilët <b>25 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku: 7 kanë titullin “Profesorë”, 4 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 9 kanë gradën Dr./PhD, dhe 5 Asistent Lektorë me Msc; dhe <b>6 pedagogë me kontratë (PAK)</b> nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 1 ka titullin “Profesorë i Asociuar”, dhe 4 kanë gradën Dr./PhD.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Shkencave Socialke të Aplikuara si departamenti përgjegjës për këtë program studimi në këtë vit akademik ka gjithsej <b>10 pedagogë</b>, nga të cilët <b>9 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku: 6 kanë titullin “Profesorë”, 2 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, dhe 1 Asistent Lektorë me Msc; dhe <b>1 pedagogë me kontratë (PAK)</b> me gradën Dr./PhD.</p> <p><i>Evidencë nr 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit (Aneks_Tabela 1dhe 2).pdf</i></p> <p><i>(Evidencë nr.4.Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit BA_SHP, pika 6, fq.4).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës është i organizuar në pesë Fakultete (11 Departamente dhe 4 qendra Kërkimore):</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</li> <li>2. Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale;</li> <li>3. Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit;</li> <li>4. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës;</li> <li>5. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;</li> </ol> <p><i>(Evidencë nr.5. Rregullore e UET, Neni. 4, fq.2).</i></p>

	<p>Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ku përfshihet edhe programi i studimit ka një eksperiencë mbi 16 vite. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore. Programi i studimit është hartuar sipas Legjislacionit në fuqi dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), dhe është i rregjistruar si program i ciklit të parë bachelor, niveli 6 i Kornizës Kombëtare të kualifikimeve.</p> <p><i>(Evidencë: nr.15. Modeli i Diplomës_Modeli i Supelementit_BA SHP)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara strukture brenda Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare <i>(Evidencë nr.26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse_Tab 3)</i>. GVJ, bazuar në RVB dhe vizitën e realizuar në institucion vërejtë që njësia bazë ishte në njohje të përgjegjësive në lidhje me programin e studimit dhe e angazhuar seriozisht për vënien e tij në jetë. Në tërësi, departamenti dhe anëtarët e tij, shefi i departamentit dhe disa prej lektorëve dëshmuuan vetëdije dhe përgjegjësi në realizimin e programit të studimit. Nga sa më sipër, vërtetohet një përputhje e plotë midis fushës së përgjithshme dhe specifike me fushën akademike e kërkimore të Departamentit përgjegjës për programin e studimit. <i>(Evidencë nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike; Shenime UET)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie</p>	<p>Rregullorja e institucionit dhe aktet e brendshme disiplinonjë institucionalisht marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda tij, duke përcaktuar rolet e përgjegjësive të përkatëse të</p>

<p>bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>drejtuesit të njësisë, përgjegjësit të grupit mësues apo koordinatorit të programit (<i>Evidencë nr.5. Rregullore e UET</i>). Peshën kryesore për mbarëvajtjen e programit e mban njësia bazë, që monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e mbarëvajtjen e programit. Organizimi i institucionit harmonizon strukturat akademike me ato vendim-marrëse dhe administrative. Nga takimet e zhvilluara në institucion si me strukturat drejtuese, stafin dhe strukturat administrative si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, konstatohet se programi bachelor në “Shkenca Politike” me profile zbatohet në kushtet e ndarjes së detyrave e përgjegjësive mes njësive dhe personelit. Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara ka hartuar rregullore të programit të studimit (<i>Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik</i>). Përveç përgjegjësit të departamentit përmes shkresës nr. 75 dt.22.12.2020 janë caktuar dhe koordinatorët e programeve të studimit të cilët kontribuojnë në ecurinë dhe zhvillimin e kurrikulës së programit të studimit (<i>Evidencë nr. 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit_Detyrat e koordinatorit të programit</i>).</p> <p>Për sa më sipër, institucioni ka përcaktuar dhe është e qartë ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësues e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Institucioni është i fokusuar dhe i hapur ndaj bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar dhe ka zyra të dedikuara dhe efektive për këtë bashkëpunim si në fushën e mobilitetit ashtu edhe në menaxhimin e projekteve të financuara prej fondeve Europiane dhe ndërkombëtare. Institucioni ka 95 marrëveshje me institucione ndërkombëtare akademike me qëllim lëvizshmërinë e studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ (<i>Evidencë nr. 34. Marrëveshje Bashkëpunimi - lista UET</i>), njëkohësisht, gëzon marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare publike dhe jo publike (<i>Evidencë nr.35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.fq.1.</i>). Gjithashtu një numër marrëveshjesh e memorandumesh janë nënshkruar edhe me aktorë biznesi për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të</p>	<p>Në dokumentin “<i>Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i>” dëshmohej se departamenti harton si pjesë të integruar informacionin analitik që lidhet me përfitimet e njësisë nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Në raport (<i>Evidencë nr.35</i>) thuhet se “marrëveshjet e bashkëpunimit, krijojnë mundësi që studentët tanë të zhvillojnë praktikat</p>

<p>realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>profesionale pranë këtyre institucioneve, duke marrë prej tyre qasjen konkrete të kërkuar nga tregu i punës”. Gjithashtu në dokumentin e sipërcituar në fq. 3-4 trajtohet specifikisht në formë tabelare se cilat janë marrëveshjet e firmosuar, institucionet dhe afatet kohore. Vërehet se këto marrëveshje shërbejnë për praktika mësimore; veprimtari të përbashkëta shkencore apo shkëmbim kapacitetesh njerëzore etj. Marrëveshjet e bashkepunimit dhe efektiviteti i tyre ka rëndësi jo vetëm në procesin e realizimit të praktikave mesimore por dhe në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore të njësisë. Sikundër është trajtuar në RVB, fakti që studentët ndjekin praktikën profesionale, në auditor, me profesionistë nga institucionet me të cilët UET bashkëpunon, është një tregues i përfitimit nga marrëveshjet, qofshin të shkruara apo të pa shkruara. <i>(Evidencë 0. RVB - BA_Shkenca Politike, fq.9)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje me institucione publike dhe jopublike që ndihmojnë studentët për kryerjen e praktikës. Këto marrëdhënie janë të rëndësishme për zhvillimin dhe zbatimin e praktikës. Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, UET ka marrëveshje zyrtare me një sërë aktorë e institucione për kryerjen e praktikave, në përputhje me natyrën specifike të programit, si me Agjensia Rajonale e Zhvillimit (ARZH), Qendra për të drejtat në punë-CRL, Bashkinë e Tiranës, Prefektura Tiranë, AIDS, Posta Shqiptare, Shoqëria KPT etj <i>(Evidenca nr.34.1 deri në nr.34.9)</i>. Në Rregulloren e programit të studimit, pika 7 e saj thuhet se: “Praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Drejtuesi i Departamentit, në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës” <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik)</i>. Institucioni ka një procedurë të miratuar ku detajohet procesi i realizimit dhe mbikëqyrjes së praktikës mësimore <i>(Evidencë nr.32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale)</i>. Konkretisht në pikën 3 të dokumentit “Mbi praktikën profesionale” përcakton se: “Strukturat përgjegjëse për zhvillimin dhe vlerësimin e praktikës janë: Departamenti dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës”. Sipas këtij dokumenti, Departamenti harton silabusin e zhvillimit të praktikës në auditor <i>(Evidencë nr.19. Praktikë dhe zhvillim karriere)</i>, dhe kalendarin e zhvillimit të seancave; realizon përzgjedhjen e ekspertëve të fushës që do të referojnë në auditor në seancat e programuara për çdo program studimi, përzgjedh dhe kontakton institucionet ku do të kryhen vizitat studimore në grup; mbikëqyr dhe ndjek seancat me ekspertët e ftuar në</p>


	auditor, duke caktuar një pedagog përgjegjës për çdo program studimi ( <i>Evidencë nr. 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale</i> ).			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Sikundër është bërë e qartë dhe në RVB, institucioni ofron trajnime shpesh për studentët në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka lidhur me institucione, organizata, me iniciativë të Departamentit dhe disa strukturave të tjera që ndihmojnë në këtë proces, të tilla si Bordet e Tregut të Punës, Klubet studentore, UET Alumni ( <i>Evidencë 0. RVB - BA_Shkenca Politike, fq.9</i> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X




## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administratë Publike”, “Gazetari”, “Studime Europiane” është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite (<i>Evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike</i>), në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi (<i>VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar</i>) dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi Bachelor në “Shkenca Politike” me profile ka 180 kredite në total dhe zgjat tre vite akademike. Në varësi të kategorizimit të lëndëve të këtij programi bëhet dhe vlerësimi me pikë kreditesh. Konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndët që i përkasin disiplinës A (Lëndë bazë) dhe disiplinën D (Lëndë Plotësuese) janë vlerësuara me nga <b>4-6 kredite (ECTS)</b>;</li> <li>- Lëndët që i përkasin disiplinës B (Lëndë karakterizuese të Programit) dhe C (Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese) janë të vlerësuara me <b>6 kredite (ECTS)</b>;</li> <li>- Punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar janë të vlerësuara me <b>7 kredite</b>;</li> </ul> <p>Një student për të mbyllur programin realizon 32 lëndë + Punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar (<i>Evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike” i licensuar me VKM Nr. 636, datë 20.09.2006, është riorganizuar me Vendim Senati, nr 7 prot, datë 14.06.2018, dhe miratuar nga MASR me shkresën 8244/1 Prot, datë 04.09.2018 në BSC “Shkenca Politike” me profile: a. Administratë Publike, b. Partite Politike, c. Sociologji Politike, d. Gazetari, e. Studime Europiane, për ndryshimet në masën 20%. Aktualisht ky program studimi ka profile active vetëm: a. Administratë Publike, b. Gazetari, c. Studime Europiane. Ky program ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe në përfundim studenti</p>






	<p>pajiset me Diplomë universitare "Bachelor" në "Shkenca Politike" me profilet përkatëse. Programi i studimit ka një kurrikul të ndërtuar me lëndë teorike dhe normative, harmonizuar kjo dhe me lëndë praktike dhe aplikative dhe ofron mundësinë e profilizimit, përmes zgjedhjes së grup-lëndëve të kategorisë C të programit. Përmbajtja e njohurive në këtë program synon formimin e shprehive të veçanta në fushën e shkencave politike dhe më gjërë, në përmbushje të kriterëve dhe në përputhje me parashikimet ligjore kombëtare në fuqi. <i>(Evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike; nr. 4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit BA_SHP).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik)</i>, takimet e realizuara me stafin akademik dhe studentët, rezultojnë se ky program synon të japë një qasje të plotë dhe të specializuar të koncepteve, formim tematik dhe aftësi për mendim kritik dhe të avancuar e të pavarur në fushën e shkencave politike. Si struktura dhe përmbajtja e kurrikulës <i>(Evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike)</i>, ashtu edhe syllabuset e lëndëve <i>(Evidencë 19. Syllabuset e lëndëve)</i>, garantojnë që programi i studimit Bsc në “Shkenca Politike” me profile, ofron njohuri të përparura në fushën e studimit. Gjithashtu, ky program mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive që pritet të kenë përfituar në kurset teorike. Programi mundëson përvetësim të literaturës kryesore të fushës së studimit dhe aftësim të plotë për zhvillim karriere.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi Bsc në “Shkenca Politike” me profile ofron mundësinë e zhvillimit të aftësive dhe kompetencave në fushën e shkencave politike sipas profilizimeve të përshtatshme për një program të ciklit të parë. Ndërthurja e komponentëve teorik me ato praktik, mundëson pajisjen e studentëve me aftësi për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e shkencave politike <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik)</i>. Programi ndërthur njohuritë e përgjithshme, të përcaktuara në Kategorinë A, me njohuritë specifike të lidhura me fushën e studimit, të përcaktuara në Kategorinë B si dhe ndërdisiplinore dhe plotësuese me lëndët e kategorisë C dhe D. <i>(Evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike)</i>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Shkenca Politike” me profile është riorganizuar me Vendim Senati, nr 7 prot, datë 14.06.2018, dhe miratuar nga MASR me shkresën 8244/1 prot, datë 04.09.2018, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në</p>



<p>programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>fuqi (Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar) si dhe në <i>Statutin dhe Rregulloren Mësimore të UET</i>. Rregullorja “është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij.” Ajo përcakton aspektet organizative të programit Bsc në “Shkenca Politike” me profile dhe “është hartuar duke respektuar lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve”. (<i>Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik</i>)</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke i grupuar lëndët/modulet sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse të shprehur në kredite ECTS (<i>Evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike</i>). Programi është i organizuar në tre vite akademike (180 ECTS), 6 semestra, me një shpërndarje optimale të ngarkesës. Kategoria A, ka një ngarkesë prej 35 ECTS dhe ka të grupuara lëndë për përgatitje metodologjike (Logjikë, Metoda Kërkimi, Shkrim Akademik, dhe Statistikë e Aplikuar) dhe lëndë për kulturë të përgjithshme (Hyrje në Sociologji, Hyrje në Filozofi dhe, Hyrje në Ekonomi). Në kategorinë B, e cila ka një ngarkesë prej 96 ECTS, janë të grupuara lëndët për përgatitjen për disiplinën e shkencave politike (Hyrje në Shkenca Politike, Hyrje në marrëdhënie ndërkombëtare, Histori bashkëkohore, Teoritë Politike, Politikë e krahasuar, Teoritë e demokracisë, Historia e shtetit dhe institucioneve, etj). Kategoria C, me një ngarkesë prej 24 ECTS, grupon lëndë ndërdisiplinore/integruese (lëndë të profilizuara). Kategoria D, me një ngarkesë prej 18 ECTS, përfshin lëndët plotësuese: Anglisht 1, Bazat e informatikës, Hartim dhe menaxhim projektesh dhe Praktikë dhe zhvillim studenti. Kategoria E përfshin detyrimin përmbyllës, dhe ka një ngarkesë prej 7 ECTS (<i>Evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike; nr.14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Shkenca Politike (Aneks_Tabela 9)</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi II.2**

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.											
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Referuar dokumentacionit të institucionit dhe RVB, konstatohet se Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara përgjegjës për programin Bachelor në “Shkenca Politike” me profile, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Ai është njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare.  Grupi i Vlerësimit të Brendshëm përbëhet nga anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit dhe një përfaqësues i studentëve të programit të studimit, dhe është ngritur me Urdhër të Rektorit të UET-it, Nr. 20, datë 24/11/2021 ( <i>Evidencë: 0. RVB - BA_Shkenca Politike</i> ).										
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Përmes shkresës nr. 75 dt. 22.12.2020 janë caktuar dhe koordinatorët e programeve të studimit të cilët kontribuojnë në ecurinë dhe zhvillimin e kurrikulës së programit të studimit ( <i>Evidencë nr. 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit Detyrat e koordinatorit të programit</i> ). Koordinator për programin Bsc në Shkenca Politike është PhD. Florian Cullhaj. Detyrat kryesore të koordinatorit përcaktohen në aneksin bashkëlidhur vendimit të emërimit, si edhe në aktet rregullatorë të UET-it. Koordinator i programit të studimit ndjek në vazhdimësi ecurinë e zhvillimit të programit dhe raporton në mënyrë periodike tek drejtuesi i Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara. ( <i>Evidencë: 0. RVB - BA_Shkenca Politike</i> ).										
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare ka në përbërje tre njësi bazë:  1. Departamenti i Shkencave Juridike; 2. Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara; 3. Qendra për Metodologjinë dhe Kërkimin Shkencor;  Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej <b>31 pedagogë</b> , nga të cilët <b>25 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 6 pedagogë me kontratë (PAK)</b> .										
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>7</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. As. Dr.</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>		Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare	PAE	PAK	Prof. Dr.	7	1	Prof. As. Dr.	4	1
Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare	PAE	PAK									
Prof. Dr.	7	1									
Prof. As. Dr.	4	1									

Dr. / PhD.	9	4
MSc.	5	0
<b>Totali</b>	<b>25</b>	<b>6</b>
	<b>31</b>	

Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara. Organizimi dhe struktura akademike e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, është konform parashikimeve ligjore në fuqi, dhe funksionojnë në bazë të akteve të brendshme rregullatore.

Departamenti i Shkencave Politike të Aplikuara, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike, me profile, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	6	0	2	0	2	1
Prof. Asoc.	2	0	3	0	2	0
Dr./PhD.	0	1	2	1	5	3
Msc.	1	0	1	0	0	1
<b>Totali</b>	<b>9</b>	<b>1</b>	<b>8</b>	<b>1</b>	<b>9</b>	<b>5</b>
	<b>10</b>		<b>9</b>		<b>14</b>	

*(Evidencë nr. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit Aneks\_Tabela 1 dhe 2).*

Gjatë vizitës në institucion në zyrën e burimeve njerëzore dosjet e personelit akademik si me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme ishin të plota. Institucioni kishte një dokumentacion të ruajtur dhe të përditësuar me të dhënat e stafit akademik i cili ishte i angazhuar në kuadër të këtij programi *(Evidencë Shënimet UET)*. Përsa i takon raportit personeli akademik efektiv/ student në nivel njësie bazë, është 1: 10. Departamenti është strukturuar në grupe mësimore, me anëtarë të departamentit sipas lëndëve të përafërta e përgjegjësat përkatës *(Evidencë: 0. RVB - BA\_Shkenca Politike)*.

Në Statutin e UET përcaktohet departamenti, si “njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies e punës kërkimore-shkencore”, “përgjegjës për programin e studimit që ofron” *(Evidencë nr.2. Statuti i UET)*. Mënyra e organizimit dhe e veprimtarisë së

	<p>departamentit si edhe detyrat e tjera të tij përcaktohen mbështetur në ligjin për Arsimin e Lartë dhe rregulloren e institucionit.</p> <p><i>(Evidencë nr. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit Aneks_Tabela 1 dhe 2). Ky kriter është përmbushur edhe në vitet e mëparshme akademike (Evidencë nr.38. Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP).</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Organizimi dhe struktura akademike e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, është konform parashikimeve ligjore në fuqi, dhe funksionojnë në bazë të akteve të brendshme rregullatore.</p> <p><i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik; nr. 5. Rregullore e UET).</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

### Standardi II.3

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës dhe takimeve të zhvilluara në institucion, konstatohet se njësitet përgjegjëse, disponojnë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit. Ky konstatim mbështetet edhe në tërësinë e dokumentacionit si: Statuti e rregullorja e institucionit, kurrikula e rregullorja e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, plani mësimor, marrëveshjet me institucione e agjenci për zhvillimin e praktikave, marrëveshje me institucione homologe ndërkombëtare, lista e publikimeve dhe veprimtarisë kërkimore, dokumentet për funksionimin e strukturave mbështetëse të institucionit, etj janë të depozituara dhe të aksesueshme nga anëtarët e njësive kryesore e bazë. Institucioni përmes platformës UET LMS (sistemi i menaxhimit online të mësimdhënies) i mundëson stafit dhe studentëve ndërveprim si në ngarkimin e literaturës për çdo lëndë, njoftimet e pedagogut, pikët e vlerësimit, dërgimi i detyrave dhe eseve nga studentët etj. Gjithashtu në web-in e UET gjenden të dhënat e detajuara lidhur me programet e</p>

	studimit. ( <i>Evidencë nr.2. Statuti i UET; nr. 5. Rregullore e UET; nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik; nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike; nr.34. Marreveshje Bashkepunimi - lista UET; nr.46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS</i> )
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit në “Shkenca Politike” me profile është i organizuar në lëndë/module, praktikë dhe aktivitete formuese, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi (Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar).
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Të gjitha lëndët/modulet, sikurse dhe detyrimet e tjera të programit të studimit, të tilla si praktika mësimore dhe detyrimet përmbyllëse (diplomimi), janë të vlerësuara me kredite ECTS, të ndara në 3 vite akademike dhe 6 semestra ( <i>evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike; nr.14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Shkenca Politike Aneks_Tabela 9</i> ).  Shpërndarja e ngarkesës mësimore ndër vite është e balancuar, sikurse dhe strukturimi i lëndëve, duke nisur me lëndë të karakterit të përgjithshëm në vitin e parë, e deri tek Praktika Mësimore dhe Detyrimet Përmbyllëse në semestrin e fundit, vlerësohen si të përshtatshme.
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Plani mësimor i detajuar ( <i>Evidencë nr.14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Shkenca Politike Aneks_Tabela 9</i> ) përfshihet informacion i nevojshëm për lëndët/modulet, viti dhe semestri kur ofrohet lënda/moduli ngarkesën mësimore. Në rregulloren e programit të studimit trajtohet mënyra e vlerësimit të dijeve dhe elementë të tjerë të procesit mësimorë. ( <i>Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik; Evidencat me nr.19. Syllabuset e lëndëve</i> ).
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacioni i nevojshëm që lidhet me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, është i përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore ( <i>Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik; nr.27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve; nr.28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin</i> ). Nga shqyrtimi i Rregullores së programit të studimit e dokumentave të tjera të posacme, GVJ konstaton se në to studentët mund të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të

	pranimi, transferimi, njohjes së krediteve dhe kushteve të mobilitetit të studentëve.			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga shqyrtimi i rregullores e syllabuseve të lëndëve të programit të studimit të ciklit të parë “Shkenca Politike” me profile, GVJ konstaton se ato i përmbahen VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL (ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019) ( <i>Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik</i> ). Formatit i syllabusit të lëndës dokumenton në mënyrë të detajuar informacionin mbi rezultatet e pritshme të të nxënësve, konceptet themelore, temat shoqëruar me literaturën e detyruar dhe të rekomanduar, kushtet e frekuentimit, formën e kontrollit të dijes dhe komponentet e tjerë formues të programit ( <i>Evidencë nr.19.1 Formatit i Syllabusit shqip/anglisht</i> ).			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit, GVJ konstaton se ajo parashikon rishikim në mënyrë periodike të programit të studimit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm: “Rishikimi i programit mund të parashikojë bashkime lëndësh ose ndarje të tyre, por pa cenuar raportet e përcaktuara për secilën kategori disiplinash në program, rishikimin e krediteve të lëndëve, të teksteve që do të përdoren por edhe të literaturës”. Ndryshimet propozohen nga Departamenti, Zyra e Kurrikulave, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me Bordet e Tregut të Punës. Si rregull, rishikimi mund të bëhet vetëm para fillimit të vitit akademik. ( <i>Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik</i> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me	Programi i studimit në “Shkenca Politike” me profile: “Administratë Publike”, “Gazetari”, “ Studime Europiane” është i organizuar në 180 ECTS, 3 vite akademike, 6 semestra, me një shpërndarje të balancuar të ngarkesës të shprehur në

<p>parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>kreditë ECTS (<i>Evidencë 14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike; 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Shkenca Politike Aneks_Tabela 9</i>), në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Duke iu referuar kornizës ligjore, një kredit (ECTS) korrespondon me 25 orë pune të një studenti dhe sasia mesatare e punës së përfunduar gjatë një viti të studimeve për një student është 60 (gjashtëdhjetë) ECTS ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë të orarit të punës së studentëve, i cili përfshin orë në auditor dhe orët e punës së pavarur.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit për programin e studimit “Shkenca Politike” me profile: “Administratë Publike”, “Gazetari”, “Studime Europiane” konstatohet se emërtimi e përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe punësimin e studentëve. Ato janë të organizuara në 5 kategori (A-E), si: lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, me vlerësimin përkatës në orë mësimore e kredite. Kombinimi i komponentëve teorik me ato praktik, vlerësohet i përshtatshëm, duke qenë se në semestrat e parë studentët pajisen me njohuri të formimit të përgjithshëm dhe karakterizues të disiplinës përkatëse, për të vijuar në vitin e fundit me praktikën mësimore dhe detyrimet përmbyllëse. (<i>Evidencë 14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike; 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Shkenca Politike Aneks_Tabela 9</i>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Vlerësohet se struktura, organizmi dhe përmbajtja e programit të studimit (<i>Evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike; 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Shkenca Politike Aneks_Tabela 9</i>), mundëson arritjen e objektivave të përgjithshme dhe objektivave specifik të programit të ciklit të parë, Bachelor në “Shkenca Politike” me profile: “Administratë Publike”, “Gazetari”, “Studime Europiane”, të përcaktuar në Rregulloren e tij. Shpërndarja e lëndëve në vite e semestra, me kreditet e orët mësimore përkatëse, përputhet me përcaktimet ligjore në fuqi dhe është në funksion të objektivave formues të programit e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin të studentëve. (<i>Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin</p>	<p>Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, lëndët dhe ngarkesa e tyre, është në përputhje me një program studimi të ciklit të parë në fushën e shkencave politike (<i>Evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike</i>), dhe përmban lëndë</p>




<p>e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>të përgjithshme dhe karakterizuese të përafërt me programe të ngjashme (kryesisht lëndët teorike), por ka dhe risi përse i takon lëndëve që përfshihen sipas profilizimeve që ky program mundëson në: “Administratë Publike”, “Gazetari”, “Studime Europiane”.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit, sikurse dhe përmbajtja e tij, mundësojnë arritjen e objektivave formues (<i>Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik; nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike</i>), transferimin e studimeve dhe mobilitetin e studentëve, sikurse dhe punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve duke qenë se i pajis me njohuri dhe kompetenca të përshtatshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik i shërben arritjes së objektivave të zhvillimit profesional dhe aftësimin për tregun e punës në përfundim të studimeve. Lidhur me mobilitetin e studentëve, numri i tyre ka qenë i pakët kjo dhe për shkak të kufizimeve nga pandemia Covid-19. (<i>Evidencë nr.43.1. Të dhëna në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve 2018-2019; nr.43.2. Të dhëna në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve 2019-2020; nr. 43.3. Të dhëna në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve 2020-2021</i>)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton se disa prej tyre bazohen në literaturë të detyruar e ndihmëse të viteve të fundit, botuar nga shtepi botuese prestigjioze. Përditësimi i programeve të lëndëve/moduleve, si një ndër komponentët e përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit është një proces periodik i cili inicohet kryesisht nga titullarët e lëndëve. (<i>Evidencë nr.19. Syllabuset e lëndëve; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike</i>)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit, për shkak të mënyrës së organizimit (sipas Kategorive A-E, raporti midis komponentëve teorik dhe atyre praktik), garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, për studentët që përfundojnë një program studimi të ciklit të parë, në fushën e shkencave politike. (<i>Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik; nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike</i>). Nga shqyrtimi i syllabuseve të programit GVJ konstaton se, me përmbajtjen e tyre, ato synojnë përfitim të dijeve, aftësive e kompetencave që ka si objektiva program.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike” me profile: “Administratë Publike”, “Gazetari”, “Studime Europiane”, mundëson vijimin e studimeve në programe të ciklit të dytë, sikurse dhe mundësinë e punësimit</p>



dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	të të diplomuarve në këtë program studimi ( <i>Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik; nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike; nr.14.1. Plani mësimor i programit - BA SHP</i> ). Lëndët e këtij programi studimi, i pajisin studentët jo vetëm me njohuri të përgjithshme, por edhe me njohuri të specializuara në disiplinën e shkencave politike, por edhe me aftësi për kërkimin shkencor, një element i rëndësishëm kryesisht për studentët që synojnë vijimin e programeve Master i Shkencave apo edhe avancime të mëtejshme.			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Nga takimet e zhvilluara në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se me anë të këtij programi studenti ka mundësinë të ndjekë një profilizim specifik me natyrë praktike dhe profesionale. Në tërësi, për organizimin e programeve të studimit dhe të planeve mësimore, UET konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve përkatëse, të organizuar në formën e Bordeve të Tregut të Punës në nivel Departamenti, për t’iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Bordet e tregut të punës, që janë integruar tashmë në strukturat e institucionit, kanë kontribuar në praktikat e studentëve, duke u bërë pjesë e auditoreve në formën e profesionistëve të ftuar, si dhe kanë kontribuar me përvojën e tyre për modelimin e syllabuseve dhe programeve, në përshtatje me nevojat e tregut. ( <i>Evidencë: Shenime UET; nr.0. RVB - BA Shkenca Politike</i> )			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike” me profile, bazuar në tabelat 6. të RVB është:

1. Për vitin akademik 2019 – 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 36 pedagogë nga të cilët 32 PAE dhe 4 PAK (88 % / 12 %);
2. Për vitin akademik 2020 – 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 31 pedagogë të gjithë PAE (100 % /0%);
3. Për vitin akademik 2021 – 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 34 pedagogë nga të cilët 32 PAE dhe 2 PAK (95 % / 5 %);

Tituj/grada	2019 - 2020		2020 - 2021		2021 - 2022	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	5	0	5	0	7	0
Prof.As.Dr	6	0	6	0	3	0
Dr/PhD	14	2	9	0	12	1
Msc	7	2	11	0	10	1
Në total	32	4	31	0	32	2
	36		31		34	

*(Evidencë nr.23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit Aneks\_Tabela 1dhe 2); (Evidencë nr 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB - BA Shkenca Politike. Tabelat 6 pdf)*

Sikundër vlerësohet dhe në analizën e realizur nga departamenti fq.15: “Stafi pedagogjik përbëhet në pjesën më të madhe të tij me lektorë të cilët kanë kualifikime shkencore të rëndësishëm. Stafi pedagogjik i angazhuar në këtë program studimi përbehet në një pjesë të rëndësishme të tij nga Prof.Dr dhe Prof.Asoc. Gjithashtu një pjesë e madhe e tij janë Doktor Shkencash, ku disa prej të cilëve kanë kryer studimet e tyre në universitetet më të mira europaine dhe botërore. *(Evidencë nr. 38. Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP).*

**Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Nga shqyrtimi i CV-ve, e veprimtarisë kërkimore - shkencore e botuese të personelit akademik, me kohë të plotë e të pjesshme të programit bachelor ne “Shkenca Politike” me profile rezulton se zhvillimi i tij realizohet nga një staf pedagogjik me përvojë dhe i kualifikuar, me tituj dhe grada shkencore, profesorë me përvojë akademike, me rol në jetën publike të vendit.

Për sa i përket kualifikimeve të personelit Akademik referuar *(Evidencë nr 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB - BA Shkenca Politike. Tabelat 6 pdf)* rezulton:

<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Për 2019-2020, 76% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 24% janë Msc;</li> <li>- Për 2020-2021, 64% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 36% janë Msc;</li> <li>- Për 2021-2022, 67% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 33% janë Msc.</li> </ul> <p>Rezulton se personeli i angazhuar ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik të përfshirë në këtë program studimi, rezulton se niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore, sikurse dhe eksperiencia profesionale, janë në përputhje me programin e studimit dhe lëndët/modulet në të cilat ato janë të angazhuar. <i>(Evidencë nr.20. CV Personeli Akademik).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga biseda me strukturat drejtuese të fakultetit dhe departamentit si dhe shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se UET ka një traditë të konsoliduar për realizimin e programeve të ciklit të parë të studimit. Programi i ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Shkenca Politike”, i ofruar nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, është akredituar për herë të parë me Urdhër të Ministrit Nr. 246, datë 24.07.2009 <i>(Evidencë nr.1. Mendimi i Dekanit per programin SHP).</i> Institucioni ka marrëveshje të posaçme dhe zgjeron bashkëpunimin me institucione, organizata dhe shoqata të ndryshme të shoqërisë civile, për realizimin e praktikave profesionale <i>(Evidencë nr.34. Marreveshje Bashkepunimi - lista UET).</i> Institucioni nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Praktikave, lidhen memorandume bashkëpunimi me shumë institucione publike dhe kompani private, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar realizimin e praktikave profesionale të studentëve në këto institucione <i>(Evidencë nr.32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale).</i></p> <p>Me programin e studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile, studenti ka mundësinë të ndjekë një drejtim specifik, me natyrë praktike dhe të zhvillojë aftësitë e njohuri profesionale. Pranë departamentit funksionojnë bordet e Tregut të punës që konsultojnë mbi organizimin e programeve të studimit dhe të planeve mësimore, për t’iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Bordet e tregut të punës, të integruara në strukturat e institucionit, kontribuojnë në praktikën e studentëve, dhe bëhen pjesë e auditoreve në formën e profesionistëve të ftuar. Edhe për komponentët e tjerë, të tillë si Diplomimi (si me Provim Diplomimi ashtu edhe</p>

	<p>Temë Diplome), vlerësohet se institucioni garanton kapacitetet e nevojshme për realizimin e tyre me sukses.</p> <p><i>(Evidencë nr.10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit; nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i kurrikulës dhe bazuar në RVB ky program studimi nuk ka orë laboratorike. Institucioni ka zyra përgjegjëse, që merret me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programeve, dhe sigurojnë mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera për zhvillimin e praktikës mësimore.</p> <p><i>(Evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike; nr.14.1. Plani mësimor i programit - BA SHP; RVB - BA_Shkenca Politike)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X




### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, përbën një objektiv të rëndësishëm të institucionit, e përcaktuar në dokumente kryesore strategjike (<i>Evidencë nr.3. Plani Strategjik 2015 – 2020; 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025; nr.4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit BA_SHP; nr.5. Rregullore e UET</i>). Në Planin Strategjik të UET 2015-2020 dhe ate pauses është përcaktuar si prioritet i procesit mësimor “<i>rritja e vazhdueshme e cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe duke nxitur të qenin proaktiv e kritik në dhënien e opinioneve mbi çështje aktuale</i>”. UET siguron një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore dhe angazhimin në hulumtim. Në funksion të përmbushjes së këtij objektivi, institucioni zhvillon trajnime për stafin akademik dhe administrativ.</p> <p>(<i>Evidencë nr. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; nr.33. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe ose studentët e diplomuar</i>)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Në UET funksionojnë mekanizma monitorimi dhe vlerësimi periodik te aftësive dhe progresit në procesin mësimdhënës të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, aplikohen: format e vetëvlerësimit, të vlerësimit nga studentët, të vlerësimit të mësimdhënies në auditor për lektor e asistent lektor nga Dekani, përgjegjësi i njësisë bazë apo përgjegjësit e grup-lëndëve. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu është i zbërthyer në indikatorë të detajuar, që mundësojnë një proces vlerësimi për një sërë komponentë të përmbajtjes e organizimit të mësimin, të pedagogjisë e komunikimit me studentët etj. Në planin vjetor të veprimit të KSBC përfshihen kontrole periodike të syllabuseve, përpunimi i të dhënave të pyetësorit online të studentëve, të pyetësorit me fokus-grup, etj. (<i>Evidencë nr.40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët; nr.30.1. Plani veprimit KSBC; nr.30.3 Strategjia per</i></p>

	<p><i>sigurimin e brendshem te cilesise; nr.30.8. G-III-4-1 Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me studentë të programit të studimit, përfaqësues të KSBC dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se institucioni garanton rolin e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të metodave të mësimdhënies, të tërheqjes së mendimit të tyre mbi programet studimore, cilësinë e aksesin e literaturës, mbi etikën e komunikimit të pedagogëve etj. Format e aplikuara për këtë qëllim janë pyetsorët e formularët e administruar nga KSBC ku analizohen “problematikat e ndeshura në procese kyçe të veprimtarisë mësimore – kërkimore (të tilla si: shpërndarja e ngarkesës mësimore në nivel departamenti, kualifikimi i personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, cilësia e mësimdhënies dhe çështje të vlerësimit të studentëve, etj.), dhe harton raportet me gjetjet përkatëse” (<i>Evidencë nr.8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, fq.2 në dok shënohet fq.101</i>).</p> <p>Gjithashtu realizohen takime periodike me studentët në formën e “fokus-grupeve”, si dhe pjesmarrja e tyre në mbledhjet e hapura të Departamentit, ndërsa Zyra e Kujdesit ndaj Studentit dokumenton rastet e ankimimeve të cilat, për problematika të përcaktuara, sic parashikon edhe rregullorja e UET, i drejtohen për shqyrtim përgjegjësit të departamentit. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit edhe pasi ka marrë shpjegimet përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës institucioni ka një procedurë që ndiqet në këto raste. Sipas rregullores “ai mund t’i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e komponentit përkatës. Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar”. (<i>Evidencë nr.5. Rregullore e UET</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e procesit të vlerësimit (pyetsore/anketa/fokus-grupe), pasi përpunohen nga KSBC si strukturë përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë apo zyra e IT kur vlerësimi është bërë online, u komunikohen autoriteteve drejtuese të institucionit dhe posacërisht përgjegjësit të departamentit që ia bën të ditur personelit akademik: Përmes një raporti të brendshëm rezultatet e KSBC-së publikohen dhe i dërgohen Rektorit dhe Administratorit të UET. Pjesët e</p>

	raportit që lidhen me Fakultetet përkatëse i vihen në dispozicion edhe Dekanëve të Fakulteteve dhe Drejtuesve të Departamenteve. Departamenti ka për detyrë të analizojë të dhënat, të verifikojë besueshmërinë e tyre dhe të marrë masa për përmirësimet e nevojshme. <i>(Evidencë nr.8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	Gjatë vizitës në institucion rezultatet pozitive të procesit të vlerësimit i shërbejnë nxitjes e inkurajimit të zbatimit të praktikave më të mira në procesin e mësimdhënies. Në mbledhjet e njësisë bazë por edhe në seminarat trainuese këto praktika shërbejnë si referenca për përmirësim të mëtejshëm të eksperiencës së mësimdhënies në institucion. <i>(Evidencë Shenime UET; RVB - BA_Shkenca Politike)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, të tilla si leksionet, seminarat, detyrat e kursit, etj, janë të përcaktuara në planin mësimor <i>(Evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike; nr.14.1. Plani mësimor i programit - BA SHP)</i> , në syllabuset e lëndëve <i>(Evidencë nr.19.Syllabuset e lëndëve)</i> , sipas përcaktimeve në Rregulloren e Programit të Studimit <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik)</i> . Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi ndjekin lëndët e kategorisë A, B, C dhe D. Studentët e regjistruar në programin Bsc në “Shkenca Politike”, ndjekin së bashku, në të njëjtën klasë lëndët e kategorive A , B dhe D të programit, ndërsa lëndët e kategorisë C ndiqen sipas profilit të përzgjedhur. Zhvillimi i praktikës, sikurse dhe detyrimet përmbyllëse janë të detyrueshme për të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi. Lëndët që ndjekin studentët në këtë program janë të karakterit të ndryshëm. Katëgoria A janë lëndët e formimit të përgjithshëm. Lëndët e katëgorisë B janë lëndë karakterizuese të programit të studimit, osë lëndët bazë të disiplinës. Lëndët e katëgorisë C janë lëndë të profilit, të cilat i

	<p>japin studentit njohur specifike dhe shtesë në profilin përkatës. Lëndët e kategorisë D janë lëndë plotësuese. Sipas krediteve ato janë ndarë përkatësisht 35 kredite të karakterit bazë të formimit të përgjithshëm, 96 kredite të karakterit formues të programit të studimit, 24 kredite të grup lëndëve të profilit 7, 18 kredite të karakterit plotësues si dhe 7 kredite punimi i diplomës ose provimi i përgjithshëm. <i>(Evidencë nr.38. Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimeve me përfaqësues të ndryshëm, u konstatua se personeli akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma të ndryshme të mësimdhënies. Duke qenë se fusha e programit të studimit "Shkenca Politike" me profile, ka një natyrë kryesisht teorike, format klasike të mësimdhënies janë mbizotëruese, të cilat adoptohen edhe në bazë të nevojave të studentëve. <i>(Evidencë Shenime UET)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Përtej parashikimeve në aktet e brendshme rregullatore mbi aspektet didaktike <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politik)</i>, institucioni mbështet stafin akademik të përcaktojë në mënyrë autonome metodat pedagogjike, në funksion të përmbushjes së qëllimit dhe objektivave të programit të studimit në tërësi, por edhe lëndëve apo moduleve të veçanta, si pjesë përbërëse të kurrikulës. Zhvillimi i trajnimeve, është një tjetër komponent që ndikon në përmbushjen e këtij kriteri. <i>(Evidencë nr.33. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe ose studentët e diplomuar).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga biseda e GVJ me stafin akademik e studente të programit si edhe nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik dhe angazhimit të tyre përkatës në lëndët e programit të studimit, rezultojnë se titullarët e lëndëve kanë një background të pasur akademik dhe shkencor në fushat e tyre të studimit dhe mësimdhënies, eksperiencë profesionale në metodologjitë e didaktikën mësimore. Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, sipas tematikave dhe profilit të lëndëve ku ata janë të angazhuar, si titullar apo si asistentë. <i>(Evidencë Shenime UET)</i></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik dhe grupin e studentëve të programit, rezulton kujdesi e përpjekja nga ana e institucionit për të përmirësuar format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë edhe mendimet e sugjerimet e studentëve (<i>Evidencë Shenime UET</i>). Procesi i vlerësimit dhe përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies parashikohet në aktet e brendshme rregullatore (<i>Evidencë nr.3. Plani Strategjik 2015 – 2020; nr.3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025</i>). Implementimi i instrumenteve të tillë, si pyetësorët dhe fokus grupet, garantojnë përfshirjen e studentëve në këtë proces periodik.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Kombinimi i metodave klasike me ato interaktive, u konstatua si nga takimet e zhvilluara me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe me studentët, ashtu edhe nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, në të cilat, në seksionin e përshkrimit të seminarit për secilën temë, evidentohen element të këtij kombinimi. (<i>Evidencë nr.19.Syllabuset e lëndëve</i>)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Përdorimi i metodave inovative, sikurse dhe kombinimi i metodave klasike me ato interaktive, garantojnë që format dhe metodat e mësimdhënies të inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit. Organizimi i detyrave në grup apo individuale, prezantimet, etj, ndikojnë në përmbushjen e këtij kriteri, i cili u konstatua edhe gjatë takimeve të zhvilluara me studentët e këtij programi studimi. Sikundër është trajtuar dhe në analizën e departamentit vlerësimi i studentëve mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Kjo i jep mundësinë studentëve që të jenë gjatë gjithë periudhës që zhvillohet lënda në kontakt me studimin dhe përgatitjen. Një nga elementët e vlerësimit janë dhe metodat e ndryshme të tij. Vlerësimi bazohet jo vetëm në kontrollin e njohurive teorike, por edhe në zhvillin e detyrave praktike si ese apo detyra kursi. Detyrat e kursit mund të jenë në formë eseje, komentar libri, punë në grup, apo detyra praktike. Detyrat zhvillohen në javën e 13 të leksioneve dhe kanë një vlerësim me 20 pikë. Gjithashtu vlerësohet pjesëmarrja dhe angazhimi i studentëve gjatë seminareve. Tezat e provimit, si ajo e provimit të ndërmjetëm, po ashtu edhe ajo e provimit përfundimtar kanë një strukturë të qartë dhe të miratuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 25 % të tezës e përbëjnë grupi i pyetjeve të kontrollit të njohurive;</li> <li>- 50 % grupi i pyetjeve analitike</li> <li>- 25 % të pyetjeve “mbaj qëndrimin tënd”;</li> </ul>

	Kjo strukturë është miratuar me qëllimin që studenti të testohet në nivele të ndryshme. <i>(Evidencë nr.38. Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Gjatë vizitës në institucion dhe vëzhgimit të infrastrukturës në funksion të programit të studimit, u konstatua se procesi mësimor realizohet në hapësira të mjaftueshme, të cilat janë të pastra dhe përgjithësisht të mirëmbajtura <i>(Evidencë nr.42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko)</i> . Godinat janë të pajisura me sistem kondicionimi dhe sistem wireles. Çdo sallë mësimore është e pajisur me PC dhe projector. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se ambientet e UET janë të pastra dhe të mirëmbajtura. <i>(Vizita në institucion)</i> .
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Nga takimet e vizita në institucion, GVJ konfirmon se mjediset që i dedikohen procesit mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme. Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara sipas funksioneve. UET ka aktualisht në përdorim 45 salla mësimore, (17 salla laboratorë-410 vende total, 13 salla për seminare- 353 vende dhe 15 salla leksioni – 1138 vende). Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht web-in. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Pajisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit. <i>(Evidencë nr.42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko; Vizita në institucion)</i> .
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për	Laboratori i informatikës, sikurse dhe sistemi i IT në tërësinë e tij, shfrytëzohet nga personeli akademik dhe nga studentët e këtij programi studimi, në funksion të realizimit të procesit mësimor. Sallat për leksionet dhe seminarët janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softëaret

<p>realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Më konkretisht, sistemet e operimit janë të gjithë Windows 10, MS TEAMS; paketa Microsoft Office 365 është instaluar e plotë me të gjithë softwarët e saj: Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PoëerPoint; Publisher; SharePoint Ëorkspace, Word, Navicat for my SQL; NetBeans; JetBrain; Apache Tom Cat; UCINET; CAD, etj. Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht webin. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhornimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit. Instalimet e programeve dhe azhornimet e tyre bëhen në kohë reale. <i>(Evidencë nr.42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko; Vizita në institucion).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me studentët e këtij program studimi si dhe dokumentacioni përkatës, rezulton se literatura bazë dhe ajo e rekomanduar (fizike dhe digjitale/në shqip edhe anglisht) është e aksesueshme për studentët. Literatura bazë dhe ndihmëse, e përcaktuar në syllabuset e çdo lënde <i>(Evidencë nr.19.Syllabuset e lëndëve)</i>, vlerësohet si e përshtatshme në funksion të garantimit të marrjes së dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Fondi i Bibliotekes per programin bachelor në “Shkenca Politike” me profile përmban në total 469 tituj <i>(Evidencë nr.45. Inventari i teksteve_shkenca politike)</i>. Bibloteka furnizohet me libra e botime periodike. Në mbështetje të programit, përgjegjësit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës. Gjithashtu, Bibloteka është e abonuar në Sage&amp;EBSCO, Questia, ASTM Compass, Edëard Elgar Publishing – Elgar Online Platform, për periudha 5 vjecare ose pa limit. Ajo është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita në Biblotekën e institucionit e biseda me punonjësit e saj si dhe bazuar në dokumentacionin përkatës, rezulton se bibloteka disponon një numër botimesh të viteve të fundit për drejtimet kryesore të programit, që janë në pasurim e sipër me tituj të rinj. Fondi i bibliotekës në dispozicion të fushës studimore të këtij programi studimi, vlerësohet si i përshtatshëm <i>(Evidencë nr.45. Inventari i teksteve_shkenca politike)</i>. Biblioteka ka hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. Pjesë e bibliotekës janë edhe libraritë online, të tilla si EBSCO dhe</p>

	ERIC, të cilat mund të aksesohen nga studentët në ambientet e bibliotekës. Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hëna-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00-17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve funksionon me orar të zgjatur. <i>(Evidencë nr.45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës).</i>
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Pjesë e bibliotekës janë edhe libraritë online, të tilla si JSTOR dhe QUESTIA të cilat mund të aksesohen në ambientet e bibliotekës, si nga personeli akademik ashtu edhe nga studentët, në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Biblioteka është e pajisur me PC, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UET. <i>(Evidencë nr.45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës)</i>
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Gjatë takimeve të zhvilluara me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, u konstatua se infrastruktura laboratorike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga ana e studentëve. Kjo infrastrukturë përdoret si për aksesimin e materialeve të ndryshme, ashtu edhe për përgatitjen e detyrave, prezantimeve dhe punimeve të diplomave. Mjediset e bibliotekës apo sallës së internetit shfrytëzohen në mënyrë efektive nga studentët.
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Personeli akademik dhe studentët e këtij program studimi, përdorin platformën MOODLE (UET LMS - sistemi i menaxhimit online të mësimdhënies mundeson ngarkim të literaturës, njoftime të pedagogut, pikët individuale të vlerësimit për studentin, dërgimi i detyrave apo eseve, etj), ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Zyra e IT në UET ka kryer trainime për përdorimin e këtyre platformave online të mësimdhënies <i>(Evidencë nr.46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS).</i> Sistemi i ofron mundësi komunikimi studentit në forume të hapura me pedagogët dhe studentët e tjerë të kursit; të shikojë notat dhe pikët on-line nga kudo që ndodhet. <i>(Evidencë nr.46.2. UET LMS Guide per pedagogun; nr.46.3. UET LMS Guide per studentet)</i>
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik	Komunikimi dhe shkëmbimi i materialeve midis personelit akademik dhe studentëve, zhvillohet kryesisht përmes platformës UET LMS. Kjo platformë i mundëson pedagogëve dhe studentëve shkëmbimin e materialeve, njoftime dhe çdo informacion që lidhet me lëndët.

dhe hapësirën vetjake të dedikuar.				
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	<p>Institucioni informon studentët mbi rregullat e lidhura me procesin e diplomimit, si për rastet kur ky detyrim final do të realizohet nëpërmjet punimit të diplomës, ashtu edhe në ato raste ku studentët do i nënshtrohen provimit të diplomimit. Departamenti hap thirrjen për temat e diplomave në javën e 5 te semestrit të pare ku çdo student me mesataren mbi 8.5 plotësojnë formularin B.II.2.2. (<i>Evidencë nr.10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i>). Lidhur me procedurën e realizimit të diplomës, anëtarët e personelit akademik, në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës, rekomandojnë tema diplome sipas profilit të fushës së studimit. Studentët pajisen nga departamenti, “me formularin e aplikimit për temën e diplomës, shoqëruar me listën e pedagogëve të mundshëm udhëheqës dhe me inventarin e temave të propozuara. Studenti plotëson formularin e aplikimit në konsultim paraprak me një pedagog dhe e dorëzon atë brenda afatit të shpallur” (<i>Evidencë nr.10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i>). Seancat metodologjike të aplikuara si orë seminaresh, kanë për qëllim të ndihmojnë studentët të përpunojnë aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës. Në to trajtohen çështje që lidhen me përcaktimin shkencor të objektit të studimit, diskutimin e dobisë së punimit, caktimin e problematikës që do të trajtohet, ndërtimin e hipotezave, trajtimin e aspekteve metodologjike, të strukturës, të burimeve parësore dhe dytësore ku do të mbështetet punimi. Departamenti cakton një pedagog udhëheqës, i cili orienton dhe mbështet studentin që nga momenti i përzgjedhjes së temës e deri në mbrojtjen e saj.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që	Institucioni ka në përbërje të strukturës së vet organizative një njësi autonome të posaçme, siç është KSBC-së, bazuar në kriteret dhe standartet europiane të sigurimit të cilësisë për

<p>promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>IAL-të. Kjo strukture vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore e propozon ndryshime për përmirësim të mëtejshme. Kompozimi i strukturës përcaktohet në statutin e UET, ndërsa në planin e veprimit të KSBC përcaktohen komponentët ku shtrihet aktiviteti i saj, me format përkatëse në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme (<i>Evidencë nr.2. Statuti i UET</i>). Gjithashtu KSBC monitoron dhe përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve nëse janë ose jo në përputhje me programet e profileve përkatëse, cilësinë e mësimdhënies së stafit akademik të programit duke aplikuar pyetësonin online të studentëve, gjithashtu vlerësohet realizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në nivel departamenti por edhe niveli i përfshirjes së studentëve në punën kërkimore, niveli i përfshirjes së studentëve në vendimmarrje, vlerësimi i trajtimit të ankesave të studentëve, rishikimi i kurrikulave, monitorohet kualifikimi i stafit akademik etj. (<i>Evidencë nr.8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë; nr.30.3 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise</i>).</p> <p>Për përmirësimin e cilësisë në veprimtarinë mësimore, kërkimore e shkencore por edhe administrative, njësia organizon edhe trajnime të posaçme, ndërsa në fund të vitit akademik hartohet raporti përfundimtar. I gjithë aktiviteti i KSBC realizohet në bashkëpunim me njësitë kryesore e ato bazë. (<i>Evidencë nr. 30.1. Plani veprimit KSBC</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara është njësia bazë që përgjigjet për cilësinë e mësimdhënies për programin e studimit që ofron. Departamenti administron dhe organizon profilet e përmbajtjen e tyre lëndore, bën përzgjedhjen e stafit akademik të programit bazuar në ekspertizën akademiko-shkencore, vlerësimin e syllabuseve e ndarjen e ngarkesës përkatëse. Departamenti ndjek në vazhdimësi performancën e anëtarëve të stafit gjatë procesit të follow-up, duke përcaktuar edhe nevojat për trajnime dhe kualifikime profesionale, sidomos të stafit të ri. Departamenti është në kontakt të vazhdueshëm me studentët për feedback-un e tyre ndaj cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit që ofrohet. (<i>Evidencë nr.5. Rregullore e UET; nr.38. Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP</i>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të</p>	<p>Liria akademike, angazhimi i një personeli me kualifikime dhe formim të përshtatshëm në disiplinat që mbulojnë (e konstatuar gjatë takimeve me personelin akademik), sikurse dhe zhvillimi i trajnimeve, janë tregues se njësitë përgjegjëse mbështesin zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies</p>



reja inovative të mësimdhënies.	<i>(Evidencë nr.20_ CV Personeli Akademik)</i> . Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të programit Bachelor në “Shkenca Politike” me profile, GVJ konstaton se formati është i strukturuar në mënyrë që të përfshijë edhe metodën pedagogjike të përdorur në mësimdhënien nga pedagogët <i>(Evidencë nr.19.1 Formati i Syllabusit shqip/anglisht)</i> . Përgjithësisht, si metoda të zhvillimit të seminareve për programin, aplikohet “diskutim e prezantim në grup”, “bashkëbisedime në auditor rreth temave të trajtuara në leksione”, “analiza konkrete të rasteve”, “debat dhe tërheqje e mendimit të studentëve për çështjet e trajtuara në leksion”, etj.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në kuadër të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja, njësitë përgjegjëse organizojnë trajnime të vazhdueshme, si për personelin akademik ashtu edhe për personelin administrativ. UET ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Në dokumentin <i>Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit BA_SHP</i> thuhet se “Në funksion të arritjes së objektivave strategjike, Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara vlerëson si prioritet mbështetjen e stafit akademik të programit të studimit, në kuadër të trajnimit të vazhdueshëm të tyre me qëllim përmirësimin e cilësisë. Ky prioritet synohet të arrihet në bashkëpunim me , Zyrën e Projekteve, Zyrën e Marrëdhënive me Jashtë, zyrën e IT, Komisionin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, duke ofruar trajnime mbi njohjen e akteve rregullatore ligjore dhe universitare të veprimtarisë akademike, standardet shtetërore të cilësisë në programin e studimit, zbatimin e procedurave dhe përmbushjen e detyrimeve akademike dhe administrative kontraktuale. Prioritet të posaçëm në këtë drejtim kanë shkëmbimet e përvojave akademike me institucione të arsimit të lartë dhe institucione kërkimore shkencore partnere vendase dhe të huaja”. Trajnimet e personelit akademik për çështje didaktike dhe të metodave kanë qenë sistematike; për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies e te përdorimit të metodave të reja, janë shfrytëzuar periudhat e shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve të financuara nga BE-ja si Erasmus + etj. <i>(Evidencë nr.3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025)</i> .
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies	Në kuadër të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja, njësitë përgjegjëse organizojnë trajnime të vazhdueshme, si për personelin akademik ashtu edhe për personelin administrativ. <i>(Evidencë</i>

dhe implementimit të metodave të reja.	<i>nr.30.11. Fisha e projektit Bologna Hub Peer Support; nr.33. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe ose studentët e diplomuar; nr.46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS).</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Bazuar në takimin me stafin akademik të programit dhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, konstatohet se përmirësimi dhe përdorimi i metodave të reja të mësimdhënies është detyrë në vazhdimësi e stafit akademik e ndihmës akademik, si testim edhe për ecurinë e performancës së tyre akademike. Në mënyrë të detyruar, syllabuset rishikohen çdo vit dhe kjo krijon mundësinë e hapësirën për përmirësime e reflektime, duke ballafaquar rezultatet dhe efektivitetin e metodologjive të përdorura.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik, në kuadër të lirisë akademike e përvojës në mësimdhënie, në përshtatje edhe me profilin e programit, përdor metoda të reja të mësimdhënies e mësimnxënies, që bëhen objekt diskutimi edhe në department, mes kolegësh si shkëmbim përvoja. <i>(Evidencë Shenime UET)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore sikurse dhe në syllabusin e secilës lëndë <i>(Evidencë nr.19.Syllabuset e lëndëve)</i> , të cilat i vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo semestri. Në përputhje me rregulloren e UET, për programin e studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile , është dhe rregullorja e programit të studimit <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike)</i> , e hartuar sipas objektivave të programit përkatës të studimit, me planin mësimor dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Në të paraqiten, ndër të tjerash, edhe kriteret e mënyra e testimit të dijeve, ku vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në



	<p>“parimin e kontrollit të vazhdueshëm”. Përcaktohen elementët e këtij kontrolli dhe pesha e tyre në vlerësimin përfundimtar. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm: Për lëndët e Tipologjisë I</p> <p>a. Provimit përfundimtar (40%);</p> <p>b. Detyrave praktike: 2 (dy) x 30% = (60%);</p> <p>Për lëndët e Tipologjisë II</p> <p>a. Provimit përfundimtar (40%);</p> <p>b. Provimit të ndërmjetëm (30%) 4;</p> <p>c. Detyrë kursi1 (20%);</p> <p>d. Nivelit të diskutimit në seminare (10%);</p> <p>Rregullorja bëhet e njohur për studentët: “Rregullorja dhe programi i studimit publikohen në fillim të çdo viti akademik. Pas kësaj, studenti konsiderohet përgjegjës për njohjen dhe respektimin e detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga kjo rregullore”. <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në syllabuset e lëndëve <i>(Evidencë nr.19. Syllabuset e lëndëve)</i>, të cilat i vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo semestri, janë të përcaktuara format e kontrollit të dijeve, të cilat bazuar në tipologjinë e lëndëve, ndahen në katër kategori kryesore: në lëndët që kanë vetëm leksione dhe seminare, lëndë që përveç leksioneve dhe seminareve, kanë edhe laboratorë, në lëndë që kanë leksione/seminare, laboratorë dhe detyra kursi, dhe lëndë që kanë leksione/seminare dhe detyra kursi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Rregullorja e institucionit, që përcakton mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive të studentit, parashikon forma të ndryshme, sipas kriterit të “kontrollit të vazhdueshëm”. Elemente kryesore të tij janë provimet, detyrat e kursit apo detyrat praktike, aktivizimi në seminare. Në këtë mënyrë, duke e ndarë vlerësimin në disa komponentë, synohet objektiviteti dhe efektiviteti më i mirë i testimit. Përsa i përket tezës së provimit, si mënyrë vlerësimi e njohurive dhe aftësive argumentuese të studentëve, ajo hartohet me 3 kategori pyetjesh, si: pyetje që kontrollojnë njohuritë (20 - 30% e tezës), pyetje që testojnë aftësitë analitike (40 - 50% e tezës), pyetje që kërkojnë mendimin dhe qëndrimin individual të studentit (20 – 30 % e tezës). Në varësi edhe të natyrës së lëndës, pedagogu përshtat format e ndryshme të kontrollit për vlerësimin e dijeve të nxëna, për t'i dhënë mundësi edhe</p>

	studentit t'i demostrojë më mirë ato. Përgjithësisht, me këto forma kontrolli, synohet të inkurajohet studenti për të mësuar sistematikisht, duke e konsideruar vlerësimin si nxitës e jo penalizues. Vlerësimi i studentit, si rregull, shoqërohet me shpjegimin përkatës. <i>(Evidencë nr. 7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve; nr.19. Syllabuset e lëndëve).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit BA Shkenca Politike <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike)</i> pika 5.2 deri në pikën 5.8.2 reflektohet procedura e testimit të vazhdueshëm të dijeve dhe aftësive të studentëve përgjatë gjithë semestrit. Në dokumentin “.A.IV Sistemi i Vlerësimit të Studentëve” përcaktohet se: “Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë. a. Nxit studentin që të mësojë gjatë gjithë vitit; b. Prodhon një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim; c. Shërben për të vlerësuar ecurinë e kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs”. Ky proces realizohet në disa komponent dhe me përqindje të saktësuar të sistemit të vlerësimit dhe reflektohet dhe tek vlerësimi përfundimtar si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Provimi i ndërmjetëm (30%);</li> <li>b) Niveli i diskutimit (10%);</li> <li>c) Detyra e kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike (20%);</li> <li>d) Provimi përfundimtar (40%);</li> </ul> <p><i>(Evidencë nr. 7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të	Institucioni vë në sistemin e vlerësimit elektronik “Clean Scoring”. Provimet zhvillohen me procedurë elektronike sekretimi (barcode) duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e

ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. <i>(Evidencë Vizita në Institucion; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në Rregulloren e Programit të Studimit <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike)</i> është përcaktuar se testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive realizohet nga pedagogu i lëndës apo në bashkëpunim me pedagogët asistent. Komisionet e posaçme ngrihen në rastin e mbrojtjes së praktikës profesionale apo mbrojtjes së punimit të diplomës. Gjithashtu në rastet e ankimimit të vlerësimit nga ana e studentit dhe marrjes në konsiderate nga ana e strukturës drejtuese, procedura e kërkon me ngritje komisioni të përbërë nga tre anëtarë.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Bazuar në pikën 5.3.2 të Rregullores së programit të studimit: “Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore”. Procesi i testimit, vlerësimit të njohurive dhe dijeve me shkrim realizohet në mënyrë anonime. Për mbarvajtjen e procesit, provimet zhvillohen me dy pedagogë në auditor. <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike).</i>
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Gjatë vizitave në institucion, u konstatua se pas zhvillimit të provimeve dhe publikimit të rezultateve, pedagogët diskutojnë me studentët mbi zgjidhjen e tij, duke ndikuar në përmirësimin e dijeve në vijim. Në pikën 5.3.4 të Rregullores Mësimore të programit të studimit përcaktohet se: “... seancat sqaruese, ku pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin”. <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike).</i>
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Institucioni dhe strukturat përgjegjëse marrin disa masa për evitimin e kopjimit dhe përdorimin e plagjiaturës në realizimin e detyrave të kursit apo punimit të diplomave. Më konkretisht në evidencen 7.1, “A.IV Sistemi i Vlerësimit të Studentëve” pika A.IV.2.6 dhe A.IV.2.7 lidhen me masat që ndermerren në këto raste. Këto masa lidhen me mënyrën sesi zhvillohet provimi duke patur dy ose dhe më shumë personel akademik me funksion mbikqyrës, njoftimin e studentëve për rregullat e sjelljes dhe të komunikimit në sallën e provimit, me moslejimin e përdorimit të mjeteve të komunikimit si dhe në rast të konstatimit të kopjimit masa ndëshkimore është e lartë. <i>(Evidencë nr. 7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve).</i> Gjithashtu në Rregulloren e Universitetit Neni 33 pika 1, 2 dhe 3 specifikohet se çfarë quhet plagjiaturë dhe kopjim

	dhe cilat janë pasojat ndëshkuese në rast të përdorimit të tyre nga studentët. <i>(Evidencë nr.5. Rregullore e UET).</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Koha e dorëzimit të provimeve është e përcaktuar në Rregulloren e UET dhe dokumentave të tjera. Brenda dy javëve nga data e zhvillimit të provimit stafi akademik duhet të realizojë korrigjimin dhe seancat sqaruese. <i>(Evidencë nr.5. Rregullore e UET).</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	E drejta për tu njohur me vlerësimin është e përcaktuar në Rregulloren e Institucionit dhe Programit të Studimit. Institucioni ka ndërtuar procedura për garantimin e kësaj të drejte si për transparencën e vlerësimit dhe për shqyrtimin e ankesave në rastet kur student nuk është i bindur për vlerësimin e marrë. Në këto raste Drejtuesi i Departamentit ngre komision me staf akademik që janë njohës të lëndës dhe realizon procedurën e rishikimit të vlerësimit duke e dokumentuar atë. <i>(Evidencë nr.5. Rregullore e UET; nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike).</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Procedura e ankimimit realizohet bazuar në nenin 32 të Rregullores së UET e cila saktëson procedurën si vijon: "...Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar." Procedura dokumentohet dhe arkivohet. <i>(Evidencë nr.5. Rregullore e UET)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e	Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit, e kombinuar me mënyrën e zhvillimit të saj, garanton thellimin e njohurive dhe aftësive profesionale <i>(Evidencë nr.14. Kurrikula</i>

<p>njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p><i>e programit BA Shkenca Politike; nr.14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Shkenca Politike Aneks_Tabela 9).</i> Viti i parë akademik nis me lëndë të përgjithshme, për të shkuar gradualisht në semestrat dhe vitet në vijim, drejtë lëndëve karakterizuese të programit dhe profilizimeve sipas drejtimeve të odruara, dhe deri tek praktika profesionale dhe diplomimi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit i kushton një hapësirë të veçantë zhvillimit të njohurive të studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit përmes lëndës “Bazat e informatikës”. Gjithashtu lëndë të tilla si Anglisht, Hartim dhe Menaxhim Projektesh, Hyrje në Komunikim, etj kontribuojnë në aftësimin e studentëve. Gjithashtu realizimi i lëndës së praktikës mësimore me seancan në auditor i ndihmon të aftësohen në ndërveprim me profesionistë të fushës. <i>(Evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Në takimin e realizuar me studentët e këtij programi na u sqarua se njohuritë dhe aftësitë e tyre lidhur me këtë program studimi ishin në përputhje me strukturën e syllabuseve dhe programit të studimit. Organizimi i procesit mësimor si dhe gërshetimi i literaturës me analizat në mënyrë të vazhdueshme si dhe realizimi i detyrave plotësuese bënin të mundur plotësimin me njohuri dhe aftësi. Përgjegjësi i grup-lëndëve ka zhvilluar për çdo lëndë indikatorët e vlerësimit të saj, ku pjesë e vlerësimit janë të gjitha kompetencat e fituara nga studentët <i>(Evidencë nr.37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve).</i> Gjithashtu stafi akademik përpara përfundimit të lëndës realizonin përsëritje të aspekteve kryesore të saj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Gjatë takimeve të zhvilluara si me personelin akademik ashtu edhe me studentët, u konstatua se në përfundim të lëndëve/moduleve, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme të trajtuara në atë lëndë/modul dhe orienton studentët për implementimin e tyre. <i>(Evidencë Vizita në Institucion; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në institucion zhvillohen leksione të hapura dhe aktivitete të tjera ekstrakurrikulare, të cilat lidhen si me zhvillimet e fundit në fushën e programit të studimit, ashtu edhe në fusha të tjera interdisiplinare apo me karakter praktik dhe aplikativ. <i>(Evidencë nr.55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021).</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë</p>	<p>Zhvillimi i procesit të mësimdhëniës realizohet mbi bazën e kompetencave duke lidhur punën individuale të studentit për realizimin e detyrave të kursit sëbashku me njohuritë e</p>



<p>studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>përftuara gjatë procesit mësimorë nga lektori përkatës. Për vetë natyrën e programit të studimit, fushës së tij, nuk gjenden shumë element të lidhur me mundësi për të zhvilluar njohuri të marra në laboratorë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët, u konstatua se personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup të studentëve. Leksionet, realizohen në mënyrë interaktive ku ndërthurin dijen teorike me atë praktike. Gjatë orëve të seminareve studentët organizohen shpeshherë në punë në grup për të diskutuar mbi çështje specifike, ndërsa ofrohen raste studimore për të identifikuar zgjidhjet e problematikave të caktuara. Në këtë mënyrë, studentët pajisen me aftësi dhe kompetenca për identifikimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme në fushën e shkencave politike.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Zhvillimi i lëndëve si Shkrim Akademik, Llogjikë dhe Metodat e Kërkimit pajisin studentët me aftësi për të kryer kërkim shkencor të nivelit që përkon me nivelin e një programi studimi të ciklit të parë (<i>Evidencë nr.14. Kurrikula e programit BA Shkenca Politike</i>). Organizimi i detyrave të kursit, sikurse dhe puna në grup apo individuale për seminarët në lëndë të ndryshme, janë tregues të krijimit të një klime të përshtatshme për përmbushjen e këtij kriteri. Ky element u konstatua edhe gjatë takimit me studentët e programit të studimit. Studentët e programit kanë mundësi të bëhen pjesë e Konferencës Studentore të organizuara nga Fakulteti dhe/ose Departamenti. (<i>Evidencë nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike</i>)</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Në Statutin e Institucionit neni 6 (<i>Evidencë nr.2. Statuti i UET</i>), manifestohet vizioni dhe ambicja e UET për të zhvilluar dhe mbështetur idetë inovative dhe studimet e avancuara. Institucioni mbështet vizionin e një “Universiteti Lider për zhvillimin e dijet, një qendër ekselence në formimin akademik të studentëve.një qendër ekselence për formimin shkencor..etj. Organizimi i konferencave, trajnimeve dhe leksioneve të hapura, ku studentët janë të ftuar të marrin pjesë, sikurse dhe organizimi i Konferencës Studentore, aktivitete të cilat organizohen dhe financohen nga institucioni, janë tregues të mbështetjes së studentëve si në aspektin organizativ ashtu edhe financiar. (<i>Evidencë nr.55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021</i>).</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese</p>	<p>Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe po punon për shtimin e tyre, konstatohet se numri i mobiliteteve si nga stafi akademik ashtu edhe studentët është i kënaqëshëm. (<i>Evidencë 43.1 deri 43.3. Të dhëna në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve 2020-2021</i>). Gjatë periudhës 2017-2022 kanë</p>

për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	përfituar nga mobilitete të tilla rreth 15 studentë të Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara, programet BA në shkencë politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare ( <i>Evidencë nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike</i> ).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në aktet e brendshme rregullatore, është përcaktuar procedura e posaçme për diplomimin, si për rastet e punimit të temës së diplomës, ashtu edhe provimit të diplomimit. Në nivel institucioni, Universiteti ka një dokument të cilësuar: “Mbi punimin e diplomës/disertacionit” B.II i cili kategorizohet si “manual procedure” dhe përshkruan procedurën e posaçme vetëm për realizimin e diplomës dhe mbrojtjes së saj ( <i>Evidencë nr.10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i> ). Gjithashtu në rregulloren mësimore të programit Bsc në Shkenca Politike dhe rregulloren e institucionit, parashikohen të gjitha rregullat e zhvillimit të provimit final, para diplomimit të studentëve të këtij programi. ( <i>Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Studentët asistohen si në aspektin e informimit të tyre lidhur me procesin e provimit final apo mbrojtjes së diplomës, ashtu edhe të përgatitjes për zhvillimin e provimit apo mbikëqyrjen e punimit të diplomës. Materialet e nevojshme për provimin final vihen në dispozicion nëpërmjet sistemit LMS, nëpërmjet e-mailit dhe procesit të këshillimit akademik me çdo anëtar të personelit akademik të institucionit. Strukturat përgjegjëse brenda departamentit kujdesen që studentët të orientohen në lidhje me literaturën përkatëse dhe të marrin gjithashtu orientime mbi shembujt e rasteve studimore që duhet të kenë në konsideratë për referim. Gjithashtu pedagogu udhëheqës realizon seanca të posaçme për ti ardhur në ndihmë studentit në këtë proces. ( <i>Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e	Studentëve u vihen në dispozicion informacionet mbi lëndët që do të testohen si dhe u vihet në dispozicion një set prej rreth

<p>provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>100 pyetjesh në total. Pyetjet përditësohen çdo vit nga stafi akademik përgjegjës për secilën prej tyre. Ato përfshijnë të gjitha lëndët e kategorise Karakterizues dhe Ndër-disiplinorë. <i>(Evidencë nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Për studentët të cilët do i nënshtrohen provimit të diplomimit, përpara zhvillimit të provimit, organizohen orë konsultimi në auditor me studentët diplomantë. Ndërsa për studentët të cilët do zhvillojnë punim diplome, orientimi dhe ndihma nis që me caktimin e temave dhe drejtuesve, e deri në momentin e finalizimit të këtij procesi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në statutin e UET Neni 50 sanksionohen të drejtat dhe detyrimet e studentit. Institucioni i mbështet studentët me infrastrukturën që ka për ti asistuar në realizimin e punës kërkimore. Roli i pedagogut është i rëndësishëm sidomos për përcaktimin e metodologjisë dhe instrumentave të kërkimit. <i>(Evidencë nr.2. Statuti i UET)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sikundër është vërejtur në dokumentacionin e shqyrtuar janë të përcaktuara qartë rolet dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit Shkencor. Ai është autoriteti që garanton dhe miraton punimin e studentit. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në të gjithë procesin, nga përcaktimi i temës e deri në përfundimin e saj. Teza quhet e përfunduar vetëm në momentin kur miratohet nga udhëheqësi shkencor, i cili përgatit edhe një relacion vlerësimi. <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike; nr.10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit).</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi i diplomimit dhe punimi i diplomës vlerësohen me pikë, nga 0 deri në 100, ku vlera minimale për kalim është 41-45 pikë. <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike).</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve në programin Bachelor në “Shkenca Politike” me profile, studentët pajisen me diplomën, listën e notave dhe suplementin e diplomës të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Pasi ka përfunduar të gjitha detyrimet ndaj institucionit studentët pajiset me diplomë brenda një afati prej 6 muajsh <i>(neni 40 i Rregullores së UET)</i>. Gjithashtu gjatë kësaj kohe ai ka të drejtë që të pajiset me vertetim dhe listë notash. <i>(Evidencë nr.5. Rregullore e UET; nr.15. Modeli i Diplomës_Modeli i Suplementit_BA SHP)</i></p>



<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti merr një kopje zyrtare të plotë të programit të studimit të zhvilluar, sikurse dhe plan programet e plota sipas kërkesës së tij. Në rast të kërkesës nga ana e studentit, institucioni e mundëson diçka të tillë. Gjithashtu në dokumentin “Mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore” pika 3.1 përcakton sekretarinë mësimore për administrimin e kërkesave të studentëve. Në këtë pikë thuhet se: “Sekretari i përgjithshëm trajton administrativisht të gjitha kërkesat/ankesat e studentëve [formati D.VI.3.1] që lidhen me aspekte administrative e akademike, dhe i përcjell ato me sqarimet e nevojshme tek autoriteti drejtues përkatës. (Evidencë nr.9. Dokumenti E.1 Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore)</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Sekretaria Mësimore, menaxhon dhe administron të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Të gjitha të dhënat e studentëve, që nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre gjenden në databazën e Sekretarisë Mësimore, si dhe në regjistrin themeltar të notave. Sekretaria Mësimore arkivon dhe mban në dosje dokumentet e çdo studenti që është i regjistruar, është çregjistruar, si dhe të studentëve që kanë mbaruar studimet e tyre. (Evidencë 5. Rregullore e UET)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p><b>Standardi IV.1</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në</p>	<p>Të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit Bsc në “Shkenca Politike” me profile, mblidhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Këto të dhëna</p>

<p>programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>përfshijnë personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Gjatë takimit me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe shqyrtimit të dokumentacionit në dosje, konstatohet se kjo Zyrë administron dokumentacionin bazë (kontratë, kualifikime, CV, etj), si dhe evidencë për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër. <i>(Evidencë Vizita në institucion)</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik në përputhje me bazën ligjore në fuqi, sikurse dhe me aktet e brendshme rregullatore. Institucioni ka një procedurë të përcaktuar në dokumentin G. Rregullore për Burime Njerëzore. Në këtë rregullore përcaktohen politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik, kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mësimore etj <i>(Evidencë nr.11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore)</i>. Gjatë vizitës në institucion me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore na u shpjeguar konkretisht procedura e ndjekur për stafin e rekrutuar. <i>(Evidencë nr.2. Statuti i UET; nr.5. Rregullore e UET)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Evidentimi i nevojave për staf akademik realizohet nga Departamenti, i cili përcjell nevojat specifike për lëndë të caktuara në Dekanat dhe pas miratimit tek strukturat e burimeve njerëzore vijojnë procedurën e shpalljes në njoftimit në faqen zyrtare të universitetit, rrjeteve sociale dhe në gazetën Liberale. <i>(Evidencë nr.11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore; nr.11.1 Shembull thirrje për staf akademik; Shënime UET)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni realizon vlerësim dhe përzgjedhje të personelit mbështetur në procedurat e përcaktuara në dokumenta si Rregullorja e UET <i>(Evidencë nr.5. Rregullore e UET)</i> dhe Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore <i>(Evidencë nr.11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore)</i>. Strukturat përgjegjëse në institucion zhvillojnë procedurën duke iu përmbajtur nevojave për staf akademik sipas profileve të kërkuara nga njësitë bazë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>


**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Ambjentet e punës janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e detyrave nga ana e stafit akademik, mjediseve moderne, hapësirave të përshtatshme, aksesit në burime elektronike dhe literaturë. Universiteti ka mjedis të përshtatshëm për realizimin e detyrave të personelit. <i>(Evidencë nr.42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta; 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni realizon disa nisma të cilat angazhojnë dhe nxisin stafin akademik për zhvillim profesional. Stafit përfshihet në organizimin dhe realizimin e konferencave shkencore, projekteve kërkimore, mobilitete në kuadër të programit Erasmus + etj. Përmes skemës së financimit të kërkimit shkencor, institucioni mbështet stafin akademik që fiton projekte kërkimore ose realizon publikime në revista dhe libra të botuara nga shtëpi botuese me reputacion ndërkombëtar në akademi. <i>(Evidencë nr.3. Plani Strategjik UET 2015-2020; nr.3.1. Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020; nr.3.2. Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025; nr.3.3. Plani Strategjik UET 2021)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni realizon trajnime 1-ditore ose më gjatë në bashkëpunim me Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit për të mundësuar kualifikimin e mëtejshëm të stafit në fushën kërkimore. Gjithashtu marrja pjesë e stafit në programet Erasmus + krijon mundësi për të përfituar nga eksperiencia dhe shkëmbimi i metodave inovative të mësimdhënies. Institucioni mundëson dhe trajnimin e stafit akademik nga zyra e TIK mbi programet LMS etj. <i>(Evidencë 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS; nr.33. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe ose studentët e diplomuar; nr.43. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit – DSHSA)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim	Institucioni ka dëshmuar një angazhim serioz në mbulimin e programit me staf akademik me tituj dhe grada shkencore.

optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Përgjatë vitin 2019-2020 personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në program ka qënë: 5 Prof. Dr., 6 Prof. Asoc 14 Dr dhe 7 Msc. Përgjatë vitit 2020-2021 personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në program ka qënë: 5 Prof. Dr., 6 Prof. Asoc 9 Dr dhe 11 Msc. Përgjatë vitin 2021-2022 personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në program ka qënë: 7 Prof. Dr., 3 Prof. Asoc 12 Dr dhe 10 Msc. Profesionalizmi dhe kualifikimi i tyre mundëson përmbushjen e objektivave të programit.  <i>(Evidencë nr. 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB - BA Shkenca Politike. Tabelat 6 pdf)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë vizitës në institucion dhe mbështetur mbi dokumentat respektive, GVJ konstaton se procesi mësimor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme (13 salla për seminare, 15 salla leksioni, 7 laboratore informatike, 1 sallë interneti dhe salla e bibliotekës) për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve dhe në përputhje me fushën e programit të studimit.  <i>(Evidencë nr.42.1.Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në UET, auditorët janë të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektor, internet dhe foni. Infrastruktura në dispozicion të procesit mësimor për programin e studimit Bachelor “Shkenca Politike” garanton realizimin e procesit mësimor. Përdorimi nga ana e studentëve dhe stafit akademik të sistemit MOODLE, UET-LMS (Sistemi i Menaxhimit të Mësimimit) krijon infrastrukturën didaktike të aksesueshme në çdo kohë. <i>(Evidencë nr.46.1. Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS; nr.46.2. UET-LMS Guidë për pedagogun; nr.46.3. UET_LMS Guidë për studentët)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera,	Institucioni e ka të gjithë infrastrukturën dhe mjetet e nevojshme për realizimin e programit të studimit Bachelor




sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	“Shkenca Politike” me profile i cili zhvillohet në salla leksioni të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore, foni dhe internet duke ju mundësuar studentëve paraqitjen dhe prezantimet e materialeve të ndryshme. Në kuadër të këtij program studimi, për nga natyra e studimeve dhe specifikave të këtij programi nuk nevojiten laboratore, studio apo atelie që të kryhet procesi mësimor. <i>(Evidencë Vizita në Institucion)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Institucioni ka laborator të teknologjisë së informacionit, por për natyrën që ka ky program studimi nuk është i nevojshëm përdorimi i tij. <i>(Evidencë Vizita në Institucion; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Kapacitetet dhe mjediset e nevojshme që disponon UET si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera, ju krijojnë studentëve mundësi për realizimin e veprimtarive praktike (të cilat lidhen kryesisht me përgatitje prezantimesh, detyra kursi, aktiviteteve të tjera etj). <i>(Evidencë Vizita në Institucion; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka vendosur në dispozicion të studentëve një bibliotekë me sipërfaqe 40 m <sup>2</sup> , dhe një sallë leximi 50 m <sup>2</sup> me 41 vende leximi duke garantuar të drejtën e studentëve për aksesimin e bibliotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin e literaturës fizike dhe jashtë ambjenteve të saj. Njëkohësisht, biblioteka është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të aksesojnë bibliotekat




	online SAGE dhe EBSCO, në të cilat është abonuar institucioni duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit BA në “Shkenca Politike”. <i>(Evidencë Vizita në Bibliotekë; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka është e pasur me literaturë fizike dhe një numër të domosdoshëm tekstesh mësimore bazë, sipas nevojave të studentëve të programit Bsc në “Shkenca Politike”. Konkretisht, biblioteka disponon rreth 469 tituj të përbërë nga (tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra, revista shkencore të nevojshme për studentët e programit Bsc në “Shkenca Politike”. Gjatë vizitës në institucion, nga punonjësja e bibliotekës u informuam mbi procedurat e pasurimit të fondit të bibliotekës. <i>(Evidencë nr.45. Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit të studimit BA “Shkenca Politike”; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike; Vizita në Institucion)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni ka krijuar akses të barabartë për studentët e programit të studimit Bsc “Shkenca Politike” në bibliotekat online (jstor, questia, etj). Abonimi në bibliotekat elektronike Sage, Ebsco dhe Questia dhe kapacitetet infrastrukturore në bibliotekë (PC, Ëi-fi) garantojnë përmbushjen e këtij kriteri. Regjistrimi dhe përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në bibliotekë është pa pagesë për studentët dhe stafin akademik. <i>(Evidencë nr.45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës Vizita në Insitucion)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka ka të gjitha programet e nevojshme kompjuterike dhe lidhjen me databazat më të mëdha të aksesit në literaturën bashkëkohore për studentët e programit të studimit Bsc “Shkenca Politike”. UET është gjithashtu abonuar në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia, biblioteka dixhitale që përmbajnë revista akademike të cilat mund të aksesohen lirisht nga stafi dhe studentët. Përmes procedurës së regjistrimit në bibliotekë sigurohej aksesimi për të gjithë studentët dhe stafin. <i>(Evidencë Vizita në Insitucion)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	UET-i ndjek një praktikë të pasurimit të fondit të bibliotekës sipas kërkesave që vinë nga njësitë bazë. Përgjegjësit e programit të studimit përmes kërkesave të marra nga stafi akademik me titujt e propozuar i përcjellin më tej në Dekanat duke filluar procedurën. Nga takimi që patëm me punonjësën e bibliotekës na u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsiderat kërkesat e stafit akademik dhe realizimi i procedurës për pasurimin e fondit realizohet në mënyrë

	periodike. <i>(Evidencë nr.45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës; Vizita në Insitucion)</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është 09.00-20.00 dhe ditën e shtunë qëndron e hapur deri në orën 17.00. Oraret e bibliotekës ishin në përshtatje të orareve mësimore. <i>(Evidencë nr.45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UET ka një sistem të menaxhimit të informacionit të quajtur UMIS. Përmes këtij programi informatik realizohet ruajtja, administrimi dhe përpunimi i të dhënave të studentit që nga regjistrimi në universitet, arrijtet akademike, lëshimin e diplomave dhe çertifikatave. Sistemi, ndër të tjerash, përmban të dhënat personale të studentit si regjistrimin e notave etj, të cilat plotësohen dhe përditësohen edhe në version elektronik. <i>(Evidencë nr.46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Platforma MOODLE, UET-LMS mundëson komunikimin, informacionin dhe materialet që lidhen me procesin mësimor ndërmjet stafit akademik dhe studentëve në kohë reale. Ky sistem mundëson lehtësira si për studentët pasi ata informohen mbi rezultatet e testimit, njoftime, materialet e lëndëve etj dhe për stafin akademik që dokumenton punën e tij përmes sistemit. <i>(Evidencë nr.46.2. LMS-Guidë për pedagogun; nr.46.3. LMS-Guidë për studentët)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë	UET përmes sistemit të menaxhimit që përdor, në bazë të programeve të studimit mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët. Përmes sistemit UMIS dhe platformës UET-LMS institucioni mundëson dokumentacionin dhe

personelin dhe studentët e programit të studimit.	komunikimin midis studentëve dhe stafit. Përmes përdorimit në nivel institucional të këtij sistemi. <i>(Evidencë nr.46.2. LMS-Guidë për pedagogun; nr.46.3. LMS-Guidë për studentët)</i>								
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Nëpërmjet përdorimit të sistemit LMS (Learning Management System) personeli akademik dhe studentët mund të komunikojnë në mënyrë interactive dhe në kohë reale. Aksesimi në këtë platformë, nëpërmjet kredencialeve përkatëse, ju mundëson studentëve materiale të ndryshme të lëndëve të programit të studimit Bsc “Shkenca Politike”, shkëmbime të informacionit midis stafit akademik dhe studentëve si dhe monitorimin e aktivitetit akademik. <i>(Evidencë nr.46.2. LMS-Guidë për pedagogun; nr.46.3. LMS-Guidë për studentët)</i>								
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Nëpërmjet përdorimit të platformës UET-LMS merren të dhëna dhe realizohen raporte mbi aktivitetin e përdorimit të saj nga anëtarët e stafit akademik për lëndët dhe grupet e veta. Ky sistem garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale. Raportime mbi aktivitetin e pedagogut dërgohen nga personi përgjegjës për menaxhimin e platformës UET - LMS në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.								
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqe zyrtare e UET përmban informacion të zgjeruar në lidhje me programet e studimit që ofrohen, personelin akademik, aktivitet e ndryshme etj, në gjuhën Shqipe dhe pjesërisht në gjuhën angleze. Informacioni mbi programin e studimit Bachelor “Shkenca Politike” aksesohet lehtësisht në linkun: <a href="https://uet.edu.al/ep-content/uploads/2021/09/BA-Shkenca">https://uet.edu.al/ep-content/uploads/2021/09/BA-Shkenca</a> . <i>(Evidencë nr.48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online; faqa e <a href="https://uet.edu.al/">https://uet.edu.al/</a>)</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB konstaton se raporti financiar hartohet dhe miratohet në nivel institucioni gjatë muajt tetor të çdo viti. Raporti <i>nuk</i> është i ndarë sipas programeve specifike. Për vetë natyrën dhe funksionimin e universiteteve private nuk realizohen raporte në nivel programi studimi rrjedhimisht nuk kishte raporte në bazë të programeve të studimit. <b><i>(Evidencë nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i></b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucional. Për shkak të natyrës, funksionimit dhe organizimit të UET si dhe përfshirjes së stafit në disa programe studimi për të realizuar normën mësimore nuk është e mundur hartimi i raporteve në bazë të programeve të studimit.</p> <p><b><i>(Evidencë nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike; Takimi me stafin akademik)</i></b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Çdo vit, UET i nënshtrohet procesit të auditimit duke shqyrtuar situatën financiare në lidhje me nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve/ investimeve të kryera. Raportet e auditimit hartohen nga auditues ligjor të pavarur në lidhje me situatën financiare, performancën, bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Mbështetur në RAPORTET E AUDITUESVE LIGJORE të vëna në dispozicion, pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) të Shqipërisë. Të dhëna të natyrës financiare janë pasqyruar në pasqyrat financiare të viteve të ndryshme ku konstatohet se gjatë tre viteve të fundit të ardhurat e buxhetit të Institucionit janë ulur. Institucioni mbështetet kryesisht në tarifat e shkollimit të studentëve.</p> <p><b><i>GVJ rekomandon që institucioni të punojë për të gjetur format e duhura për një promovim e marketing më efikas duke marrë në konsiderat sfidat që ka ky profil studimi.</i></b></p>

	<p>Konkretisht: Të ardhurat e përfuara nga Tarifat për dhe gjatë shkollimit</p> <p>a) viti 2018 / 826,521,616 lekë;</p> <p>b) viti 2019 / 663,300,718 lekë;</p> <p>c) viti 2020 / 579,766,029 lekë;</p> <p>Këto të dhëna janë rezultat edhe i uljes së numrit të studentëve gjatë viteve të fundit. <i>(Evidencë nr.50. 1. Pasqyrat financiare 2018 me shënime; nr.50. 2. Pasqyrat Financiare 2019 me shënime; nr.50. 3. Pasqyrat Financiare 2020 me shënime)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Bazuar në RVB raportet përmbajnë transparencë përsa i takon kontabilizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve. Në nivel institucioni raportet janë periodike, të përvitshme. Sikundër është theksuar dhe më lartë për shkak të natyrës, funksionimit dhe organizimit të UET si dhe përfshirjes së stafit në disa programe studimi për të realizuar normën mësimore nuk është e mundur hartimi i raporteve në bazë të programeve të studimit, pra për këtë program studimi nuk ka një raport specifik financiar. <i>(Evidencë nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>GVJ, bazuar në vizitën në institucion dhe takimin me përfaqësues të GVB dhe Stafin Akademik, u informua se për këtë program studimi Institucioni ka ndjekur politikën e mbështetjes së tij, duke ofruar dhe bursa për studentët e këtij programi, politikë e cila mundësohet nga qëndrueshmëria dhe mjaftueshmëria e kapaciteteve financiare. Është qëndrueshmëria financiare e cila garanton vijueshmëri e programit BA në Shkenca Politike. <i>(Evidencë nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike; Vizita në institucion)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni ka një kuadër të plotë të hartimit dhe zbatimit të procedurave për zhvillimin e aktivitetit akademik si: Statut, Rregullore Universitetit, Strategji, Vendimet e Senatit Akademik, Rregullore e Programit të studimit e deri tek Dok. D.I. “Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve”. Në dokumentin D.I “Mbi politikat, kriteret e pranimit për të tre ciklet e studimit që ofron ky universitet dhe procesin e pranimit të studentëve” bëhet e qartë politika që ndjek institucioni: informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese (Guida UET) si edhe gjatë këshillimit në institucion. Politikat e ndjekura në institucion janë konform legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të universitetit. <i>(Evidencë nr.27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve, <a href="https://uet.edu.al/si-te-aplikojme/">https://uet.edu.al/si-te-aplikojme/</a>)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në bazë të dokumentacionit të shqyruar si: Statutin dhe Rregulloren e UET, Rregullore e Programit të studimit BA “Shkenca Politike” me profile, rezultojnë se politikat dhe procedurat e ndjekura nga UET përpara i takon pranimit dhe përfundimit të studimeve janë transparente dhe të njëjta për të gjithë studentët. <i>(Evidencë nr.2. Statuti i UET; nr.5. Rregullore e UET (Nenin 42); nr.7. Rregullore e programit të studimit BA Shkenca Politike).</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në dokumentacionin e shqyrtuar si Statuti i UET, Rregullore e UET dhe dokumenta të tjerë, vërehet që kriteret dhe procedurat e pranimit, të përzgjedhjes, të transferimit dhe njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme janë të kuptueshme dhe të aksesueshme edhe online. Studentët kanë mundësi që të aksesojnë kriteret e pranimit dhe të njohin procedurat nëpërmjet vizitës në institucion, takimeve informuese, broshurave dhe nëpërmjet faqes zyrtare të UET. <i>(Evidencë nr.27.1 Dokumenti D.I.Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e	Përpara fillimit të regjistrimit, Institucioni bën publike kriteret dhe procedurën e pranimit për programet e ciklit të parë të studimit. Kriteret janë të përcaktuara në Nenin 11 të

kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Rregullores së UET mbi "Pranimin e studentëve". Ky informacion është i aksesueshëm pasi publikohet në faqen zyrtare të universitetit. <i>(Evidencë nr.5. Rregullore e UET; <a href="https://uet.edu.al/">https://uet.edu.al/</a>)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Institucioni mbështetet mbi kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të cilat hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe të përcaktuara në Rregulloren e UET. Institucioni ka disa forma të informimit dhe orientimit mbi kërkesat e kriteret që ka programi i studimit si: takimet informuese në institucion; përdorimi i faqes zyrtare; rrjeteve sociale etj. <i>(Evidencë nr.27.1 Dokumenti D.I.Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve)</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Institucioni ka disa forma të informimit dhe orientimit mbi kërkesat dhe kriteret që ka programi i studimit Bsc "Shkenca Politike". Institucioni organizon fushata informuese me maurantët nëpërmjet takimeve të organizuara në shkollat e mesme për ti informuar mbi ofertën akademike të institucionit. Informimi kryhet kryesisht nëpërmjet takimet informuese në institucion; përdorimi i faqes zyrtare; rrjeteve sociale etj. Përpara fillimit të çdo viti akademik UET zhvillon Javën e Orientimit për të ndihmuar studentët e rinj që të njihen me programet, pedagogët, ambientet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. <i>(Evidencë nr.48 Dokumenti E.V Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe	Në bazë të dokumentacionit të shqyruar GVJ konsatoi se që në hyrje të studimeve e deri në diplomim, studentët informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si; kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtari akademike, kulturore, njoftime,

<p>kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>sikurse dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p>Në dokumente të tilla si: Rregullore e UET neni 29 “Kalimi në vitin pasardhës”, Rregullore e programit të studimit Bsc Shkenca Politike, dokumenti D.I Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve, dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore, gjëndet informacioni mbi kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentit. Gjithashtu përdorimi i platformave UMS dhe LMS, u mundëson studentëve informacion dhe njohje të vazhdueshme të përparimeve akademike në kohë reale. Studenti mund të informohet edhe pranë sekretarisë mësimore apo tek koordinatori i programit të studimit mbi përparimin e tij akademik. <i>(Evidencë nr.5. Rregullore e UET; nr.7. Rregullores të programit të studimit BA “Shkenca Politike”; nr.27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve; nr.9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Procedura për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme është e përcaktuar në një sërë dokumentash që institucioni disponon: Statuti i UET, Rregullore e UET, Rregulloren mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin etj. Nëpërmjet Zyrës së Kujdesit, studentët marrin informacion për programin Bsc “Shkenca Politike”, informohen në lidhje me njohjen e kualifikimeve të tyre të mëparshme ose të kryera herët në kohë, si dhe lehtësojnë studentin me vlerësime paraprake për transferim studimesh apo njohje të tyre. Në Statutin e UET, neni 37 “Transferimi dhe njohja e periudhave të studimit”, në Rregullore UET, neni 35 “Transferimi dhe mobiliteti i studentëve”, në Dokumentin D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin janë të përcaktuara kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve. Më konkretisht, në nenin 35 të Rregullores së UET përcaktohet se: UET-i pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera, sipas procedurave të parashikuara me dokument të veçantë. Në çdo rast, studentit duhet të ndjekë në UET së paku një vit akademik. Studenti duhet të fitojë përmes programit të UET jo më pak se 25% të ECTS-ve në kategoritë e lëndëve A-D, si dhe të përmbushë detyrimet përmbyllëse (Kategoria E) të programit të studimit. Mbi këto dokumente bazohet realizimi i procedurës dhe informim mbi këto procese i studentëve. <i>(Evidencë nr.2. Statutin e UET; nr.5. Rregullore e UET; nr.28.</i></p>




	<b>Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin).</b>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informimi i studentëve lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve realizohet në disa forma:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njëpërmjet Rregullores së UET mbështetur në Nenin 23 (Sistemi i vlerësimit) dhe neni 24 (Mënyra e kontrollit dhe e vlerësimit të dijeve);</li> <li>2. Njëpërmjet Rregullores të programit të studimit BA “Shkenca Politike” (<i>Evidencë nr. 7 Rregullores të programit të studimit BA “Shkenca Politike” dhe (Evidencë nr. 7.1 Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve).</i></li> <li>3. Njëpërmjet syllabuseve lëndore që jepen nga personeli akademik në orën e parë të fillimit të çdo lënde (<i>Evidencë nr. 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit BA Shkenca Politike</i>)</li> <li>4. Njëpërmjet personelit akademik të cilët informojnë studentët për programin e studimit Bsc “Shkenca Politike” si dhe mbi procedurat e vlerësimit të dijeve;</li> </ol> <p>Rregullorja e programit të studimit dhe silabuset aksesohen online nga studentët.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni organizon seanca informimi mbi punimin e diplomës duke ndjekur një procedurë të mirëpërcaktuar në dokumentin B.II. “Mbi punimin e diplomës/disertacionit”. Ky dokument përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike e deri tek formatimin konkret të punimit, dorëzimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës/disertacionit. GVJ u informua nga takimi me anëtarët e GVB dhe nga takimi me studentët për zbatimin konkret të këtij procesi. (<i>Evidencë nr.10. Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit; Takimi me GVB; Takimi me Studentët</i>)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Përgjatë vitit akademik, institucioni realizon takime informuese ose takime të hapura në universitet me maturantë duke i informuar mbi programet e studimit që ky universitet ofron, organizon fushata të ndryshme publicitare, shpërndan broshura informuese në lidhje me programet e studimit etj, ndërsa përpara fillimit të vitit të ri akademik, UET zhvillon Javën e Orientimit për t’ju ardhur në ndihmë studentëve të rinj që të njihen me programet, pedagogët, ambjentet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Konkretisht, përgjatë javëve të regjistrimit, institucioni vendos grupe pedagogesh për të informuar studentët e interesuar. Gjithashtu, për një komunikim të institucionalizuar mes studentit dhe</p>

	<p>institucionit, ekziston një procedurë e përcaktuar në dokumentin A.V Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik. Në këtë dokument përcaktohet se: Tutoriati dhe këshillimi akademik zhvillohen gjatë gjithë vitit akademik (java e parë e Shtatorit – java e fundit e Qershorit) në të njëjtin orar (E premtë 15:00-17:00), të shpallur që në fillim të vitit. Një burim tjetër informimi janë dhe mbledhjet e departamentit, të cilat zhvillohen të hapura për studentët e interesuar. <i>(Evidencë nr. 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik; nr. 10.3. Kalendari akademik 2020-2021; nr. 10.4. Kalendari akademik 2021-2022)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka disa forma të informimit të studentëve përsa i takon njohjes me strukturën dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Në dokumente të tilla si <i>Rregullore e programit të studimit BA “Shkenca Politike”</i> gjendet informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Gjithashtu, studenti mund të informohet përmes faqes zyrtare online të institucionit <a href="https://uet.edu.al/">https://uet.edu.al/</a>, përmes zyrës së kujdesit të studentit, nga stafi akademik, kontratës që nënshkruan me institucionin etj. Këto struktura dhe dokumente u mundësojnë studentëve informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit. <i>(Evidencë nr.7. Rregullore e programit të studimit BA “Shkenca Politike”; Vizita në Institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Mundësitë e informimit fizik dhe jo vetëm merren në institucion pranë disa zyrave apo njërive që ofrojnë informacione për çdo program të detajuar që interesohet studenti. Në dokumente të tilla si <i>Statuti i UET, Rregullore e UET apo Rregullore e programit të studimit BA “Shkenca Politike”</i> janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet që i takojnë studentit. Në Statut neni 50.1 përcakton se: “Statuti i studentit fitohet me regjistrimin e tij në UET...”. Që në momentin e regjistrimit, studenti pajiset me numër</p>

	<p>matrikullimi dhe gëzon të gjitha të drejtat e studentit. Ai pajiset me informacionin e duhur që lidhet me programin e studimit që përmban lëndët dhe modulet e tij. Institucioni siguron akses dhe informacion për studentët në lidhje me elementët e programit të studimit që ata ndjekin përmes platformës ëeb-it, platformës LMS dhe stafit akademik që realizon programin. <i>(Evidencë nr.12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit)</i></p>																
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit si dhe Alumnit janë strukturat që realizojnë procesin e informimit dhe këshillimit të studentëve gjatë dhe pas diplomimit. Institucioni organizon panairë të tregut të punës si dhe ka strukturën e bordit të tregut të punës që mundëson lidhjen e studentëve të punësuar me universitetit. Gjithashtu zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit të Studentëve bëjnë njoftime për mundësi punësimi.</p> <p>Mbështetur në të dhënat e tabelës Nr.1: Shkalla e punësimit ndër vite për studentët e diplomuar në programin BA Shkenca Politike <i>(Evidencën nr. 17. Studimi për tregun e punës)</i>, shohim që numri i studentëve që kërkojnë të regjistrohen në këtë program studimi është ulur e rjedhimisht dhe numri i të diplomuarve është ulur.</p> <table border="1" data-bbox="603 1120 1369 1384"> <thead> <tr> <th>Viti Akademik</th> <th>Të diplomuar</th> <th>Të punësuar</th> <th>Të punësuar %</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017- 2018</td> <td>24</td> <td>16</td> <td>66%</td> </tr> <tr> <td>2018- 2019</td> <td>36</td> <td>4</td> <td>11%</td> </tr> <tr> <td>2019- 2020</td> <td>22</td> <td>2</td> <td>9%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>(Evidencë nr.12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; nr.12.1. Bordi i Tregut të Punës 2019-2020; nr.12.2. Poster panairi i punës 2018 dhe 2019)</i></p>	Viti Akademik	Të diplomuar	Të punësuar	Të punësuar %	2017- 2018	24	16	66%	2018- 2019	36	4	11%	2019- 2020	22	2	9%
Viti Akademik	Të diplomuar	Të punësuar	Të punësuar %														
2017- 2018	24	16	66%														
2018- 2019	36	4	11%														
2019- 2020	22	2	9%														
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga takimet e realizuara në ambientet e UET, gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua mbi sistemin dhe strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Institucioni, përmes koordinatorës së departamentit, mban komunikim dhe informonte studentët për njoftimet që lidheshin me procesin mësimor. Gjithashtu njoftimet vendoseshin dhe në këndin e njoftimeve. Njoftimi realizohej dhe në rrugë elektronike përmes postes elektronike të studentit apo sistemit LMS.</p>																



	<i>(Evidencë Vizita në Institucion; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i>			
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Institucioni përmes Javës së Orientimit ju vjen në ndihmë studentëve të rinj që të njihen me programet, pedagogët, ambientet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Kjo formë organizimi ndihmon për të shpërndarë informacionin por dhe për të sqaruar çdo paqartësi nga ana e studentëve përmes kontaktit direkt me stafin administrativ dhe akademik. Në takimin e realizuar me studentët e programit Bsc “Shkenca Politike” u vërejt fakti se ata vlerësonin sistemin LMS. Sipas studentëve, sistemi u krijonte shumë lehtësi në komunikimin me stafin akademik të angazhuar në program, aksesin e leksioneve në formatin elektronik dhe çdo informacion tjetër që lidhet me organizimin e programit mësimor. <i>(Evidencë Vizita në Institucion; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.4



**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Bazuar në Rregulloren e UET, neni 19 pika 1 dhe 2 thuhet se: “Regjistrimi i studentëve bëhet në katër regjistra: themeltar, i amzës, i diplomave, dhe i lëndës, të cilët mbahen në formë elektronike dhe në formë të shkruar. Regjistri themeltar, i amzës dhe i diplomave, bazuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin (MASR) për mbajtjen e tyre, plotësohet me të dhënat e studentëve në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Çdo student, në regjistrimin fillestar, pajiset me një numër unik matrikullimi, sipas udhëzimeve të MASR, numër që e shoqëron studentin deri në marrjen e diplomës. Gjatë vizitës në institucion, në zyrën e sekretarisë mësimore, GVJ pa nga afër mënyrën e ruajtjes së dokumentacionin që lidhet me statistikat vjetore për numrin e studentëve të diplomuar në Bsc “Shkenca Politike”. Rregjistrat e notave dhe ai themeltar ishin në kushte optimale, të plotësuara dhe të ruajtura nga stafi i sekretarisë. GVJ konstatoi se në regjistrin themeltar

	<p>sekretaria mësimore nuk i ruan të dhënat e studentëve të këtij programi në bazë të ndarjes së profileve të studimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që duke qënë se programi i studimit është me 3 profile kjo gjë të reflektohet në vijim në regjistrat që mban sekretaria mësimore.</i></p> <p>Të dhënat disponoheshin në versionin elektronik gjithashtu. Institucioni disponon statistika për studentët e diplomuar në vite. <i>(Evidencë nr.5. Rregullore e UET; nr.9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore; Vizita në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ iu vu në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program, ata që ishin çregjistruar dhe ata që ishin me status aktiv.</p> <p>Mbështetur në <i>(Evidencën nr. 27 Cilësia në hyrje dhe dalje për programin) rezultun:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– V.A. 2019-2020; 25 student regjistruar (3 të çregjistruar);</li> <li>– V.A. 2020-2021; 11 student regjistruar (2 të çregjistruar);</li> <li>– V.A. 2021-2022; 11 student regjistruar (0 të çregjistruar)</li> </ul> <p><b>Totali i studentëve 42 studentë, në një cikël;</b></p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 numri i të diplomuarve është 22 studentë ndërsa për vitin akademik 2020-2021 rezultun se numri i të diplomuarve është 15 studentë. Përmes sistemit LMS institucioni i disponon statistikat në çdo kohë. <i>(Evidencë Shënime UET; Vizita në Institucion; 0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në UET u informua se institucioni disponon për çdo student dosjen me të gjitha të dhënat që nga momenti i fillimit të programit dhe deri në përfundimin e tij. <i>(Evidencë nr. 9. Dokumenti E-I. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore).</i> GVJ, në takimin e realizuar pranë sekretarisë mësimore, pa nga afër dosjen e një studenti, e cila përmbante të gjitha dokumentat e duhura si: diploma dhe lista e notave e noterizuar, kontrata, ID etj. Përzgjedhja e saj u bë në mënyrë rastësore. <i>(Evidencë Shënime UET; Vizita në Institucion; 0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Institucioni përmes sistemit UMIS (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit) realizon ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentëve. Zyra e IT-së është përgjegjëse për administrimin e të dhënave në sistem dhe për menaxhimin teknik të sistemit UMIS. <i>(Evidencë 0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Mbështetur në <i>(Evidencën nr. 27 BA Shkenca Politike -Cilësia në hyrje dhe dalje për programin)</i> jepen të dhëna mbi cilësinë e performancës akademike të studentëve që kanë frekuentuar këtë program studimi. Për vitin akademik 2019-2020 nota mesatare në hyrje e studentëve ishte 7.58 dhe në dalje nota mesatare ishte 7.08. Për vitin akademik 2020-2021 nota mesatare në hyrje e studentëve ishte 7.82 dhe në dalje nota mesatare ishte 7.06. Në lidhje me punësimin të dhënar gjenden në <i>(Evidencën nr. 29. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve_Tabela 23)</i>. Nga tabela shohim që numri i të diplomuarve është ulur në këtë program studimi e rrjedhimisht dhe numri i të punësuarve është ulur.</p> <table border="1" data-bbox="614 582 1364 846"> <thead> <tr> <th>Viti Akademik</th> <th>Të diplomuar</th> <th>Të punësuar</th> <th>Të punësuar %</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017 - 2018</td> <td>24</td> <td>16</td> <td>66%</td> </tr> <tr> <td>2018 - 2019</td> <td>36</td> <td>4</td> <td>11%</td> </tr> <tr> <td>2019 - 2020</td> <td>22</td> <td>2</td> <td>9%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>(Evidencën nr.27. BA Shkenca Politike -Cilësia në hyrje dhe dalje për programin; nr.29. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve_Tabela 23).</i></p>				Viti Akademik	Të diplomuar	Të punësuar	Të punësuar %	2017 - 2018	24	16	66%	2018 - 2019	36	4	11%	2019 - 2020	22	2	9%
Viti Akademik	Të diplomuar	Të punësuar	Të punësuar %																	
2017 - 2018	24	16	66%																	
2018 - 2019	36	4	11%																	
2019 - 2020	22	2	9%																	
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>																

<p><b>Standardi V.5</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UET, studentët përfshihen në disa struktura drejtuese me karakter mesimor-kërkimor dhe shërbime. Përfaqësuesit e studentëve përfshihen në struktura si: Senati Akademik; Këshilli i Studentëve/Këshillat e Studentëve në nivel njësie kryesore; 1 student në Këshillin e Etikës; 1 student në KSBC. Gjithashtu një herë në muaj studentët mund të marrin pjesë në mbledhjen e hapur që organizohet nga departamenti. <i>(Evidencën nr.2. Statuti i UET; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni ju garanton studentëve përfshirjen dhe të drejtën e përfaqësimit përmes të zgjedhurve të tyre në strukturat e përcaktuara. Krahas detyrimeve të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e UET, institucioni përdor disa forma të përfshirjes së studentëve dhe në vlerësimin e procesit akademik përmes Fokus Grupeve dhe Pyetësorëve Online. Rezultatet e këtyre instrumentave trajtohen në nivel të strukturave drejtuese. Nga vizita në institucion dhe takimi që kemi patur me përfaqësues të KSBC na u sqarua procedura dhe realizimi i këtij procesi. <i>(Evidencën nr.2. Statuti i UET (neni 50 dhe 51); nr.5. Rregullore e UET (neni 42); Takimi me përfaqësues të KSBC-së; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Për analizën e këtij kriteri, GVJ shqyrtoi një sërë dokumentash, si Plani mësimor i programit BA Shkenca Politike, dokumentin; Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Shkenca Politike dhe dokumentin Analiza e departamentit. Sikundër vërehet dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga rezultatet e Analizës së Departamentit, ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Ka një ndarje të balancuar të ngarkesës mësimore sipas semestrave, gjë që ju jep mundësi studentëve të mos jenë të mbingarkuar dhe të realizojnë një program të mirë koordinuar midis semestrave. <i>(Evidencë nr.14. Plani mësimor i programit; nr.14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Shkenca Politike; nr.38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Gjatë takimit në institucion me dekanen dhe përgjegjës të departamentit u theksua rëndësia dhe vlera e përfshirjes së studentëve në procesin e vlerësimit të procesit akademik si dhe realizimi i mbledhjeve të departamentit në formatin e hapur ku ftohen dhe studentët. Pjesëmarrja dhe angazhimi i studentëve në këto procese shërbejnë si instrumente për të matur perceptimin e studentëve në raport me programin e studimit në tërësi. <i>(Evidencë Vizita në Institucion; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët si dhe nga kqyrja e dokumentacionit vërehet se studentëve u mundësohet transparenca dhe barazia në marrjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në Rregulloren e Universitetit, përcaktohet procedura në rast ankese nga studenti (neni 32 “Kërkesa për Rivlersim”). Sipas kësaj procedure, studenti realizon ankesën pas shpjegimeve përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Studenti mund t’i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e komponentit përkatës në tezë. Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar...etj. <i>(Evidencën nr.5. Rregullore e UET; nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>



<p><b>Standardi V.6</b> <b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Institucioni ka një zyrë të Kujdesit ndaj Studentit (ZKS) e cila ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin. Ajo shërben si burim primar i informacionit dhe këshillave rreth mundësive të studimit. Anëtarët e stafit ndihmojnë studentët të përfshihen në jetën e kampusit, i mësojnë studentët në lidhje me politikat e Universitetit, ndërmjetësojnë mosmarrëveshjet organizative dhe individuale, këshillojnë programe dhe aktivitete të veçanta, mbështesin studentët për qeverinë studentore, menaxhojnë hapësirën ku qëndrojnë studentët e qeverisë. <i>(Evidencë nr.12. Dokumenti E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; nr.27.2. Dokumenti A-V Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin,</p>	<p>Institucioni ka një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin e studentëve në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit. Që në fillim të vitit akademik shpallet kalendari i tutoriatit dhe këshillimi akademik zhvillohen gjatë</p>

<p>ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>gjithë vitit akademik me orare të përcaktuara. Çdo anëtar i personelit të brendshëm akademik ka në ngarkim një grup studentësh dhe qëndron 1 (një) orë në javë në një zyrë/sallë të caktuar, në funksion të këtij shërbimi, gjatë një orari pa ngarkesë mësimore ose administrative. Në fillim të semestrit, pedagogu propozon pranë Koordinatorës së Departamentit orën e këshillimit, i cili pasi miratohet nga Drejtuesi i Departamentit, publikohet dhe mbetet i pandryshuar deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. <i>(Evidencë nr.27.2. Dokumenti A.V., A.V.1., A.V.2.2 Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Kujdesit ndaj Studentit (ZKS) shërben si burim primar i informacionit dhe këshillave rreth mundësive të studimit. Gjithashtu ZKS ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij. Tutoriati dhe këshillimi akademik zhvillohen gjatë gjithë vitit akademik (java e parë e Shtatorit – java e fundit e Qershorit) në të njëjtin orar (E premtë 15:00-17:00), të shpallur që në fillim të vitit. Brenda këtij orari zhvillohen edhe seancat metodologjike. Studenti këshillohet të ruajë kontaktet me të njëjtin pedagog përgjatë gjithë ciklit të studimeve. Zyra mban kontaktet e studentëve të interesuar, me të cilët komunikon vazhdimisht (email – list) si dhe ruan kontaktet e studentëve edhe pas diplomimit. <i>(Evidencë nr.12. Dokumenti E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Këshillimit dhe Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar, dhe ka një bazë të dhënash në lidhje me punësimin apo vazhdimin e mëtejshëm të studimeve të tyre. Institucioni ka një shoqatë Alumnit (<a href="http://uet.edu.al/neë/uet-alumni-10-vite-me-pas/">http://uet.edu.al/neë/uet-alumni-10-vite-me-pas/</a>) e cila realizon takime periodike me studentët. Ata janë gjithashtu pjesë e bordeve të tregut të punës pranë departamenteve. <i>(Evidencë nr.12. Dokumenti E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; dokumentacioni shtesë nr.3.2. Alumni 2021)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UET janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC). <i>(Evidencë nr. 2. Statuti i UET; nr. 5. Rregullore e UET)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni ka Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) i cili ka për detyrë vlerësimin periodik të veprimitarisë mësimore e kërkimore. KSBC ka akses në të gjitha të dhënat e UET. Institucioni ka Strategji për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017 – 2022 për realizimin e objektivave të cilësisë. Gjithashtu zyra e Standardeve dhe Cilësisë realizon politikat, strategjitë dhe proceset për të garantuar cilësinë në UET. Institucioni angazhon dhe ekspertë të jashtëm pranë KSBC-së. Strukturë tjetër e rëndësishme në sigurimin e brendshëm të cilësisë është dhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC). <i>(Evidencë nr.2.Statuti UET; nr.5.Rregullore UET; nr.30.3 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise; nr.8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Institucioni përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit në mënyrë të vazhdueshme. <i>(Evidencë Vizita në Institucion; Shënime UET)</i>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka politika dhe procedura të qarta përsa i takon sigurimit të cilësisë. Struktura përgjegjëse KSBC, programon punën në bazë të strategjisë/manualit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, dhe planit të veprimit të përvitshëm. Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese të njësive bazë. <i>(Evidencë nr.30.3 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise; nr.30.1. Plani veprimit KSBC)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi VI.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në Statutin UET, neni 11 i tij përcaktohet se: “UET harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm”. Në Rregulloren e institucionit përcaktohet zyra e Standardeve dhe Cilësisë si dhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) i cili vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore-shkencore, të UET-it. Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë është KSBC-ja. Në nivel njësie bazë është Departamenti i cili ka programin e studimit së bashku me strukturat e tij të brendshme si koordinatorët e programeve dhe përgjegjësit e grup-lëndëve. <i>(Evidencë nr. 2. Statuti i UET; nr. 5. Rregullore e UET)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Ka disa dokumenta ku vërtetohet se institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin e syllabuseve dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit <i>(Evidencë 30.5 Metodologjia e punes se KSBC_Provimet; 30.6. Format_Raporti për provimet; 30.7. Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset)</i>. Kështu, në dokumentin A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, përcaktohen parimet mbi të cilat duhet të mbështetet stafi akademik për ndërtimin e tyre <i>(Evidencë nr.39. Dokumenti</i></p>






	<p><b>A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës).</b> Kryetari i KSBC kryen ndarjen e punës midis anëtarëve të Komisionit, shpërndan dokumentet dhe udhëzimet e nevojshme për kryerjen e vlerësimit të planeve lëndore. Gjatë realizimit të procesit, konstatimet e anëtarëve të KSBC gjatë shqyrtimit të planeve lëndore, shënohen në matricat përkatëse për çdo Fakultet. Në përfundim, anëtarët e KSBC i dorëzojnë Kryetarit matricat përkatëse për hartimin e Raportit përmbledhës të përputhshmërisë së planeve lëndore. Institucioni përmes KSBC-së realizon raporte vlerësimi periodike vjetore mbi elementë të ndryshëm të programeve të studimit në nivel Universiteti.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Në Universitetin Europian të Tiranës funksionojnë mekanizma monitorimi dhe vlerësimi periodik të aftësive dhe progresit në procesin mësimdhënës të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, aplikohen: <i>format e vetëvlerësimit, të vlerësimit nga studentët, të vlerësimit të mësimdhënies në auditor për lektor e asistent lektor nga Dekani, përgjegjësi i njësisë bazë apo përgjegjësit e grup-lëndëve (Evidencë Shënime UET)</i>. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu është i zbërthyer në indikatorë të detajuar, që mundësojnë një proces vlerësimi për një sërë komponentë të përmbajtjes e organizimit të mësimin, të pedagogjisë e komunikimit me studentët etj (<i>Evidencë nr.30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu</i>). Në planin vjetor të veprimit të KSBC përfshihet kontrollë periodike të syllabuseve, përpunimi i të dhënave të pyetësorit online të studentëve, të pyetësorit me fokus-grup, etj (<i>Evidencë nr.30.1. Plani veprimit KSBC</i>). Institucioni dhe struktura përgjegjëse KSBC përmes planit të veprimit të përvitshëm si dhe aktiviteteve me karakter monitorues nga Departamenti dhe njësia kryesore realizon vlerësimin në nivel institucional të të gjitha programeve të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka një procedurë të mirë përcaktuar për realizimin dhe dokumentimin e vlerësimeve dhe bërja me dije e tyre tek autoritetet përgjegjëse. Më konkretisht, në dokumentin “Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë” në pjesën ku cilësohet: “Procedurat dhe aktivitete për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë” janë të përcaktuara me detaje instrumentat mbi të cilat ndërtohet raporti (<i>Evidencë nr.30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>). Gjithashtu, në dokumentin “F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë” thuhet se: “Rezultatet e KSBC-së publikohen përmes një</p>




	raporti të brendshëm që i dërgohet Rektorit dhe Administratorit të UET. Pjesët e raportit që lidhen me Fakultetet përkatëse u vihen në dispozicion edhe Dekanëve të Fakulteteve dhe Drejtuesve të Departamenteve” ( <i>Evidencë nr.8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</i> ). Gjatë vizitës në institucion, GVJ në takimin e realizuar me përfaqësues të KSBC, u sqarua se për të realizuar raportet periodike, zyra e KSBC-së përdor disa forma vetëvlerësimit dhe se raportet e realizuara nga KSBC-ja janë në dispozicion të strukturave drejtuese dhe stafit. Këtu mund të përmëndim dokumentin Format raporti për provime, Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët. Rezultatet e raporteve trajtohen në disa nivele brenda institucion. ( <i>Evidencë Shënimet UET</i> )			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Bazuar në dokumentin Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë, struktura e raporteve të vlerësimit përfshin rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë ( <i>Evidencë nr.30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i> ). Pjesët e raportit që lidhen me fakultetet përkatëse u vihen në dispozicion dekanëve të fakulteteve dhe drejtuesve të departamenteve, të cilët diskutojnë me stafin mbi vlerësimin e marrë dhe hapat që do të ndjekin për përmirësimin e mëtejshëm të njësisë. Monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në kuadër të mangësive të konstatuara realizohet nga KSBC-ja. ( <i>Evidencë nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike</i> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe financiare të UET-it. KSBC-ja realizon vlerësim periodik në nivel institucional tek të gjitha programet e studimit ( <i>Evidencë nr.8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</i> ). Kjo strukturë nuk harton relacione specifike në bazë

<p>institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>programi. Departamenti ka realizuar një analizë të përgjithsme për programin e studimit bachelor “Shkenca Politike” me profile. <i>(Evidencë nr.38. Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi më anëtarë të KSBC (dhe shqyrtimi i RVB-së) na u bë me dije se përdoren disa instrumeta për realizimin e procesit të vlerësimit si: metoda të tërthorta, të drejtpërdrejta si dhe instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. Në çdo semestër me anë të sistemim LMS realizohet vlerësimi për çdo lëndë të çdo pedagogu nga studentët; Përdorimi i fokus grupeve; Vlerësimi nga Përgjegjësi i Departamentit; Follow up me stafin etj. <i>(Evidencë nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike; Shënime UET)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rezulton se institucioni përdor forma të ndërthurura për realizimin e vlerësimit dhe ruajtjes së cilësisë së programit të studimit. Për kategorinë lektor/asistent lektor realizohen monitorime nga ana e eprorëve dhe për këtë ka një format standard ku përfshihen komponentë si organizimi dhe qartësia e leksionit; komunikimi me studentët etj. <i>(Evidencë nr.30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu).</i> Në përfundim të procesit hartohet një raport vlerësimi mbi rezultatet e monitorimit. Gjithashtu vlerësimi që japin studentët për procesin mësimor nga sistemi LMS është një tjetër instrument. Format i vlerësimit të performancës akademike të studentëve bëhet nga një ndërthurje instrumentash si testim me shkrim, detyra kursi, aktivizimi etj. <i>(Evidencë nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike; Shënime UET)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë</p>	<p>Institucioni përdor disa metoda e instrumente vlerësimi. Institucioni garanton rolin e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të metodave të mësimdhënies, të tërheqjes së mendimit të tyre mbi programet studimore e modulet e lëndëve, mbi cilësinë e aksesin e literaturës, mbi etikën e komunikimit të pedagogëve. <i>(Evidencë 40. G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët).</i> Format e aplikuar për këtë qëllim janë pyetësorët e formularët e administruar nga KSBC dhe takimet periodike me studentët në formën e “fokus-grupeve”. Këto instrumenta analizohen dhe, nëpërmjet tyre, evidentohen problematikat e ndeshura</p>

në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	në procese kyçe të veprimtarisë mësimore – kërkimore (të tilla si: shpërndarja e ngarkesës mësimore në nivel departamenti, kualifikimi i personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, cilësia e mësimdhënies dhe çështje të vlerësimit të studentëve, etj.). Në të gjithë këtë proces, KSBC është struktura përgjegjëse për realizimin e procesit të vlerësimit dhe hartimin e raporteve me gjetjet përkatëse në nivel institucional. <i>(Evidencë nr.5. Rregullore e UET; nr.8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë; nr.40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Sipas <i>Rregullores së UET</i>, standardet dhe cilësia, përfshijnë disa struktura si:</p> <p>a. Zyra e Standardeve dhe Cilësisë;</p> <p>b. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore-shkencore, të UET-it. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të tij rregullohet me dokument të veçantë;</p> <p>c. Zyra e Burimeve Njerëzore;</p> <p>d. Zyra e Kurrikulave;</p> <p>Institucioni realizon politika dhe procedura të brendshme të cilësisë duke përfshirë disa aktorë në proces si:</p> <p>-Bordet e tregut të punës;</p> <p>-ekspert të jashtëm;</p> <p>-përfshirja në projekte ndërkombëtare me fokus sigurimin e cilësisë së brendshme si TEMPUS “ENCHASE” <i>(Evidencë nr.30.9. Fisha e projektit Enchase)</i> dhe Erasmus+ QainAL <i>(Evidencë nr.30.10. Fisha e projektit QainAL)</i>. Përfshirja në këto projekte ka krijuar shkëmbime përvojash, trajnime, vizita studimore si dhe procese të tjera që lidhen me</p>

	monitorimin dhe vlerësimin e funksionit e sigurimit të cilësisë së brendshëm.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UET, në dokumentin “Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë”, si dhe në dokumentin F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë të përcaktuara përgjegjësitë dhe detyrat e njërive të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Më konkretisht zyra e Standardeve dhe Cilësisë, kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit. Ndërsa Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademi e administrative dhe studentët e programit të studimit.	KSBC ngrihet në nivel universiteti dhe anëtarët e tij propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati i Universitetit. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve ad hoc, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit ( <i>Evidencë nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike fq.46</i> ). Komisioni operon me një plan vjetor që miratohet në fillim të vitit nga Rektori ( <i>Evidencë nr.8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</i> ). Në përbërje të Komisionit ka një Kryetar, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm ( <i>Evidencë nr.30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC</i> ). Ka disa standarde të cilat respektohen për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit-KSBC-së (si:kompetenca profesionale, paanshmëria...etj). Komisioni fokusohet tek shqyrtimi i syllabuseve, tezave të provimit etj. Sikundër është trajtuar dhe më lart, raporti është në nivel institucional. KSBC-ja nuk realizon raporte në nivel program studimi. Departamenti ka realizuar një analizë mbi ecurinë e programit të studimit.  <i>GVJ rekomandon që analiza të kësaj natyre të realizohen edhe në nivel programi studimi.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike	Në procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj pabarazie

<p>të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>kundrejt stafit dhe studentëve (<i>Evidencë nr.30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>). Realizimi i pyetësorëve të vlerësimit të stafit akademik nga ana e studentëve bëhet duke ruajtur anonimatën e studentit. Për të shmangur subjektivitetin e vlerësimit të studentëve, pyetësori realizohet para dhënies së provimit; në këtë mënyrë, studenti nuk influencohet nga rezultati për mendimet e shprehura në pyetësor. Gjithashtu, në raste të problematikave të evidentuara nga përpunimi i të dhënave dhe trajtimi i tyre në raport, personeli akademik informohet nga eprori mbi rezultatet e dala. Duhet theksuar gjithashtu fakti që, për përzgjedhjen e anëtarëve të KSBC, ruhen disa standarde të tilla si: kompetenca profesionale, paanshmëria, nuk duhet të jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të universitetit, etj. Këto kritere e bëjnë punën e KSBC efikase dhe të paanëshme. (<i>Evidencë nr.8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Institucioni angazhon ekspertë të jashtëm në strukturën e KSBC-së (<i>Evidencë nr.30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC</i>). Në dokumentin <i>F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i> thuhet se: “Komisioni përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm”. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë dhe studentët e diplomuar dhe të punësuar të cilët janë pjesë e strukturës e Bordi i Tregut të Punës, të cilët japin kontribut në këtë proces.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.5</b></p>	
<p><b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të</p>	<p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vepron në bazë të një plani veprimi vjetor të miratuar nga Rektori i institucionit (<i>Evidencë nr.30.1. Plani veprimit KSBC</i>). Manuali</p>

<p>Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017 – 2022 janë gjithashtu dokumenta të cilët përcaktojnë politikat dhe organizimin e veprimtarisë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë (<i>Evidencë nr.30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>). Këto dokumenta sikundër pranohet në RVB fq.50 “...se raportet e KSBC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat Raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë”. (<i>Evidencë nr.0. RVB - BA_Shkenca Politike</i>)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Vlerësimi i realizuar nga strukturat përgjegjëse është në nivel institucional. Rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese dhe në departament trajtohet me stafet akademike elementë që lidhen me veprimtarinë e tyre. (<i>Evidencë nr.8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>). Raportet e KSBC-së nuk janë të aksesueshme.</p> <p><i>GVJ sygjeron. që përmbledhjet e rezultateve të raportit dhe masave propozuese, të jenë publike dhe të aksesueshme për studentët dhe më gjerë.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Institucioni realizon një proces vijueshmërie të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat i raportit. Sipas RVB-së disa nga masat e marra lidhen me aktivitete për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve akademike përmes realizimit të seminareve të trajnimit me natyrë didaktike të mësimdhënies apo për kërkimin shkencor. (<i>Evidencë nr.8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë; nr.30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Përpjekjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional. Përmes kontrollit të kryqëzuar, strukturat dhe aktorë të brendshëm të UET reflektojnë mbi rezultatet e raportit dhe realizojnë masa që lidhen me programet e studimit për ta përmirësuar më tej. (<i>Evidencë nr.8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë; nr.30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Realizimi i vlerësimit të përvitshëm nga ana e KSBC-së përmes planit të punës mundëson angazhimin e strukturave akademike dhe studentët në proces. Aksesin në dokumentat ku bazohet kjo veprimtari është e mundur si për stafin akademik, administrativ dhe studentët në nivel institucional. (<i>Evidencë nr.30.1. Plani veprimtarie KSBC; nr.8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>)</p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor Shkenca Politike, me profile: a. “Administratë Publike”; b. “Gazetari” c. “Studime Europiane”;**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Universiteti disponon një kuadër të plotë ligjor dhe rregullator, që mundëson disiplinimin e procesit mësimor e kërkimor - shkencor dhe një praktikë shumë të mirë të ruajtjes së dokumentacionit sipas standardeve dhe kërkesave ligjore dhe nënligjore në fuqi;
2. Universiteti ka një sistem informatik eficient dhe përdor platforma dixhitale që i vinë në ndihmë studentëve, duke mundësuar akses dhe informim në kohë reale;
3. Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit ka eksperiencën dhe kualifikimet e duhura, në funksion të përbushjes së objektivave të programit të studimit;
4. Përdorimi i metodave interaktive dhe përfshirja e studentëve në këtë proces, evidentohet si një pikë e fortë e këtij programi studimi;

**b. Pika të dobta:**

1. Institucioni mbështetet kryesisht në tarifat e shkollimit të studentëve, dhe është vulnerabël ndaj trendit në ulje të numrit të studentëve për këtë program studimi; (*Standardi IV.6 / kriteri 3*)

**Rekomandime:**

1. GVJ rekomandon që të punohet për të gjetur format e duhura për një promovim e marketing më efikas duke marrë në konsiderat sfidat që ka ky profil studimi;
2. Sugjerohet që departamenti që ofron këtë program studimi të ndërmarrë një studim cilësor dhe sasior të tregut, të detajuar ku të jepen të gjitha analizat, statistikat, rezultatet dhe alternativat mbi bazën e së cilës do të mund të këtë vijueshmëri dhe aftësi konkurruese si program studimi;
3. GVJ konstatoi se në regjistrin themeltar sekretaria mësimore nuk i ruan të dhënat e studentëve të këtij programi në bazë të ndarjes së profileve të studimit. Rekomandohet që duke qënë se program i studimit është me 3 profile kjo gjë të reflektohet në vijim në regjistrat që mbanë sekretaria mësimore;



4. Raporti i realizuar nga KSBC është në nivel institucional.Rekomandohet që analiza të kësaj natyre të realizohen edhe në nivel programi studimi;

**Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in “Political Sciences, with profiles: a. “Public Administration”, b “Journalism”, c. “European Studies”**

**a. Strengths and affirmations:**


1. The University has a complete legal and regulatory framework, which enables the discipline of the teaching and research-scientific process and a very good practice of preserving documentation according to the standards and legal and by-law requirements in force;
2. The University has an efficient IT system and uses digital platforms that help students, enabling access and information in real time;
3. The program is covered by qualified academic staff with degrees and qualifications that guarantee the quality an objectives fulfillment of the study program;
4. The use of interactive methods and the involvement of students in this process is evidenced as a strong point of this study program;

**b. Weak points:**

1. The institution relies heavily on student tuition fees, and is vulnerable to the decreasing trend in the number of students for this study program; (*Standardi IV.6 / kriteri 3*)

**Recommendations:**

1. The External Evaluation Group recommends working to find the right forms for a more efficient promotion and marketing, taking into account the challenges of this study profile;
2. It is suggested that the department that offers this study program undertake a qualitative and quantitative market study, detailed where all analysis, statistics, results and alternatives are given on the basis of which it will be able to this continuity and competitiveness as a study program;
3. The external evaluation group found that in the basic register, the teaching secretariat does not store the data of the students of this program based on the division of study profiles. It is recommended that since the study program has 3 profiles, this should be reflected in the registers kept by the teaching secretariat;
4. The report carried out by Internal Quality Assurance Commission is at the institutional level. It is recommended that analyzes of this nature are also carried out at the study program level;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

